



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 10 prot.

Kamëz, më 22.01 2024

V E N D I M

Nr 10 Datë 22/01 / 2024

MBI

“MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL 2024-2026”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 22.01.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.07 Datë 16.01.2024 në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “për Vetqeverisjen Vendore”, Ligjit nr.57 dt. 18/07/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr.121/2016 “Për shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “për masa ndaj dhunës në marrëdhënie familjare”, ligji 22/2018 “për strehimin social”, Ligjit nr.9970, datë 24.07.2018 “Për barazinë gjinore në Shqipëri”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.150 datë 20.03.2019 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror” si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Kamëz nr.103 datë 18.12.2023 “Mbi detajimin e buxhetit për vitin 2024, 2025, 2026”; Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e Planit Social 2024 – 2026.
2. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E NDIHMËS EKONOMIKE DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE

Nr. 07 prot.

Kamëz, më 16 . 01 . 2024

PROJEKT - VENDIM

Nr 07 Datë 16/01 / 2024

PËR

“MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL 2024-2026”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “për Vetqeverisjen Vendore”, Ligjit nr.57 dt. 18/07/2019 “për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr.121/2016 “për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr.18/2017 “për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “për masa ndaj dhunës në marrëdhënie familjare”, ligji 22/2018 “për strehimin social”, Ligjit nr.9970, datë 24.07.2018 “për barazinë gjinore në Shqipëri”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.150 datë 20.03.2019 “për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror” si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Kamëz nr.103 datë 18.12.2023 “mbi detajimin e buxhetit për vitin 2024, 2025, 2026”;

PROPOZJË:

1. Miratimin e Planit Social 2024 – 2026.

Bashkëngjitur këtij projekt-vendimi gjendet Plani Social për periudhën 2024-2026.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Drejtore i Nd. Ekonomike
dhe Çështjeve Sociale

Raimonda Nikolli

Drejtore i Çështjeve Ligjore
dhe Prokurimeve Publike

Luan Dedaj

Drejtore i Financës dhe
Kontabilitetit

Vjollca Smaçi

KRYETARI

Rakip SULLI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E NDIHMËS EKONOMIKE DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE

Nr. ____ prot.

Kamëz, më ____ . 01 . 2024

RELACION

MBI

“MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL 2024-2026”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “për Vetqeverisjen Vendore”, Ligjit nr.57 dt. 18/07/2019 “për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 121/2016 “për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 18/2017 “për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “për masa ndaj dhunës në marrëdhënie familjare”, ligji 22/2018 “për strehimin social”, Ligjit nr.9970, datë 24.07.2018 “për barazinë gjinore në Shqipëri”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 150 datë 20.03.2019 “për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror” si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Kamëz nr.103 dt 18.12.2023 “mbi detajimin e buxhetit për vitin 2024, 2025, 2026”, në cilësinë e strukturës përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në Bashkinë Kamëz, i propozojmë Këshillit Bashkiak:

- Miratimin e Planit Social 2024-2026.

Plani Social i Bashkisë Kamëz, i prezantuar në vazhdim, është një dokument i bazuar në një qasje gjithëpërfshirëse, i cili synon të adresojë nevojat për shërbime sociale, fuqizimin e strukturave përgjegjëse vendore, si dhe përmirësimin e shpërndarjes dhe llojshmërisë së shërbimeve.

Plani është hartuar përmes një procesi konsultimi me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse vendore, shoqërisë civile, ofrues të shërbimeve si dhe grupeve në nevojë, për të garantuar një vlerësim sa më afër nevojave reale të tyre dhe mundësive për ti adresuar këto nevoja tek aktorët e duhur.

Plani Social synon të përmirësojë mirëqenien shëndetësore, shoqërore dhe ekonomike të individëve, fëmijëve dhe familjeve, veçanërisht të atyre në kushte sociale ose ekonomikisht të pafavorizuara, duke garantuar shanse të barabarta dhe parimet e drejtësisë sociale. Ndër të tjera synon reduktimin e varfërisë, sidomos varfërisë ekstreme, duke garantuar një jetesë dinjitoze për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E NDIHMËS EKONOMIKE DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE

familjet/individin dhe fëmijët, duke nxitur zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive të tyre nëpërmjet adresimit të nevojave në kontekstin e rehabilitimit, integritit në tregun e punës dhe të shërbimeve shoqërore.

Plani Social, parashikon ndërhyrje në disa drejtime kryesore:

1. Fuqizimi i strukturave dhe kapaciteteve të shërbimeve sociale.

Masat e parashikuara përfshijnë: (a) Ngritja e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe e Referimit të Rasteve (NjVNR); (b) Ngritja e strukturave të supervizimit të shërbimit të mbrojtjes së fëmijëve në bashki; (c) Fuqizimi i strukturave të shërbimit social dhe të strehimit në bashki; (d) Fuqizimi i bashkëpunimit me strukturat e shëndetësisë;

2. Zhvillimi i sistemit të integruar dhe të organizuar të shërbimeve të kujdesit shoqëror për të mundësuar mirëqënien, pavarësinë dhe përfshirjen shoqërore të individëve dhe familjeve në nevojë.

Masat e parashikuara përfshijnë: (a) Ofrimi i shërbimeve sipas vlerësimit të nevojave të familjeve/individëve; (b) Ngritja e strukturave të ofrimit të shërbimit në komunitet; (c) Zgjerimin e kapacitetit të bashkisë për ofrimin e shërbimeve emergjente/direkte për familjet/personat në nevojë/fëmijët/viktimat e dhunës; (d) Përmirësimi i infrastrukturës në institucione/investime publike/hapësira publike për kategoritë në nevojë.

3. Zgjerimi i hartës së shërbimeve sociale në Bashkinë Kamëz.

Masat e parashikuara përfshijnë: (a) Zhvillimi i partneriteteve me OJF; (b) Zgjerimi me shërbime të reja të ofruara në bashkinë Kamëz në bashkëpunim me OJF; (c) Zgjerimi me përfshirjen aktive të komunitetit në shërbime sociale; nxitja e vullnetarizmit në ofrimin e shërbimeve.

4. Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë.

Masat e parashikuara përfshijnë: (a) Mbështetja dhe fuqizimi i familjeve në nevojë; (b) Mbështetja dhe fuqizimi i grave kryefamiljare (veçanërisht nënat me shumë fëmijë të grupmoshave nën 18 vjeç); (c) Mbështetja dhe fuqizimi i komunitetetit Rom dhe Egjiptian.

5. Zhvillimi i komponentit parandalues të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Masat e parashikuara përfshijnë: (a) Të rritet niveli i ndërgjegjësimit në komunitet; (b) Përfshirja e komunitetit në vendimmarrjet që lidhen me sistemin komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E NDIHMËS EKONOMIKE DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE

Për zbatimin e këtij Plani dhe përmbushjen e objektivave të tij, Bashkia Kamëz duhet të ngrejë Fondin Social për periudhën 2024-2026, në masën 287,712,804 lekë.

Për vitin e parë, Bashkisë i nevojitet 76.4% e buxhetit total të këtij Plani (219,964,268 lekë).

Për vitin e dytë, i nevojitet 11.8% e buxhetit total të këtij Plani (33,874,268 lekë).

Për vitin e tretë, i nevojitet 11.8% e buxhetit total të këtij Plani (33,874,268 lekë).

Për vitin e parë, Bashkia ka fonde të planifikuara, por jo në masën e nevojshme, për disa nga aktivitetet e parashikuara në Planin Social.

Buxheti që ajo ka tashmë për vitin e parë është 116,301,200 lekë. Në këto kushte hendeuku i financimit për vitin e parë është 103,411,604 lekë.

Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale do të identifikojnë vazhdimisht donatorë të mundshëm, për të mundësuar aplikimin dhe më pas mbështetje, për shërbimet që duhet të ngrihen në përputhje me Planin Social. Kjo do të mundësojë mbulimin e kostove të hendeikut financiar të krijuar për vitin e parë të zbatimit dhe në vazhdimësi.

Bashkangjitur do të gjeni:

- 1) Planin Social 2024-2026
- 2) Tabelën e Buxhetit

Duke shprehur në miratimin e këtij projekt-vendimi dhe duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Konceptoi:

Alltane DURA

Përgjegjëse e Sektorit të ndihmës ekonomike

Erina HALILI

Përgjegjëse e Sektorit të Paftësisë

Gilma BAJRAMAJ

Përgjegjëse e Sektorit të Mbrojtjes Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore

Arjola GJUTA

Koordinatorë e Dhunës në familje

Miratoi:

Drejtor/ Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale

Raimonda NIKOLLI



This project is funded
by the European Union



Linja e Këshillimit
për Gra dhe Vajza

116 117



PLANI SOCIAL BASHKIA KAMËZ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E NDIHMËS EKONOMIKE DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE

Kamëz, më 16. 01 . 2024

Nr. 07 prot.

PROJEKT-VENDIM

Nr 07 Datë 16/01/2024

PËR
“MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL 2024-2026”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “për Vetqeverisjen Vendore”, Ligjit nr.57 dt. 18/07/2019 “për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr.121/2016 “për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr.18/2017 “për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “për masa ndaj dhunës në marrëdhënie familjare”, ligji 22/2018 “për strehimin social”, Ligjit nr.9970, datë 24.07.2018 “për barazinë gjinore në Shqipëri”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.150 datë 20.03.2019 “për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror” si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Kamëz nr.103 datë 18.12.2023 “mbi detajimin e buxhetit për vitin 2024, 2025, 2026”;

PROPOZOJMË:

1. Miratimin e Planit Social 2024 – 2026.

Bashkëngjitur këtij projekt-vendimi gjendet Plani Social për periudhën 2024-2026.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Drejtore Nd. Ekonomike
dhe Çështjeve Sociale

Raimonda Nikolli

Drejtore Çështjeve Ligjore
dhe Prokurimeve Publike

Luan Dedaj

Drejtore Financës dhe
Kontabilitetit

Vjollca Smaçi

KRYETARI

Rakip SULI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E NDIHMËS EKONOMIKE DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE

Kamëz, më ____ . 01 . 2024

Nr. ____ prot.

RELACION

MBI

“MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL 2024-2026”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “për Vetqeverisjen Vendore”, Ligjit nr.57 dt. 18/07/2019 “për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 121/2016 “për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 18/2017 “për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “për masa ndaj dhunës në marrëdhënie familjare”, ligji 22/2018 “për strehimin social”, Ligjit nr.9970, datë 24.07.2018 “për barazinë gjinore në Shqipëri”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 150 datë 20.03.2019 “për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror” si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Kamëz nr.103 dt 18.12.2023 “mbi detajimin e buxhetit për vitin 2024, 2025, 2026”, në cilësinë e strukturës përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në Bashkinë Kamëz, i propozojmë Këshillit Bashkiak:

- Miratimin e Planit Social 2024-2026.

Plani Social i Bashkisë Kamëz, i prezantuar në vazhdim, është një dokument i bazuar në një qasje gjithëpërfshirëse, i cili synon të adresojë nevojat për shërbime sociale, fuqizimin e strukturave përgjegjëse vendore, si dhe përmirësimin e shpërndarjes dhe llojshmërisë së shërbimeve.

Plani është hartuar përmes një procesi konsultimi me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse vendore, shoqërisë civile, ofrues të shërbimeve si dhe grupeve në nevojë, për të garantuar një vlerësim sa më afër nevojave reale të tyre dhe mundësive për ti adresuar këto nevoja tek aktorët e duhur.

Plani Social synon të përmirësojë mirëqenien shëndetësore, shoqërore dhe ekonomike të individëve, fëmijëve dhe familjeve, veçanërisht të atyre në kushte sociale ose ekonomisht të pafavorizuara, duke garantuar shanse të barabarta dhe parimet e drejtësisë sociale. Ndër të tjera synon reduktimin e varfërisë, sidomos varfërisë ekstreme, duke garantuar një jetesë dinjitoze për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E NDIHMËS EKONOMIKE DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE

familjet/individin dhe fëmijët, duke nxitur zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive të tyre nëpërmjet adresimit të nevojave në kontekstin e rehabilitimit, integritit në tregun e punës dhe të shërbimeve shoqërore.

Plani Social, parashikon ndërhyrje në disa drejtime kryesore:

1. Fuqizimi i strukturave dhe kapaciteteve të shërbimeve sociale.

Masat e parashikuara përfshijnë: (a) Ngritja e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe e Referimit të Rasteve (NjVNR); (b) Ngritja e strukturave të supervizimit të shërbimit të mbrojtjes së fëmijëve në bashki; (c) Fuqizimi i strukturave të shërbimit social dhe të strehimit në bashki; (d) Fuqizimi i bashkëpunimit me strukturat e shëndetësisë;

2. Zhvillimi i sistemit të integruar dhe të organizuar të shërbimeve të kujdesit shoqëror për të mundësuar mirëqënien, pavarësinë dhe përfshirjen shoqërore të individëve dhe familjeve në nevojë.

Masat e parashikuara përfshijnë: (a) Ofrimi i shërbimeve sipas vlerësimit të nevojave të familjeve/individëve; (b) Ngritja e strukturave të ofrimit të shërbimit në komunitet; (c) Zgjerimin e kapacitetit të bashkisë për ofrimin e shërbimeve emergjente/direkte për familjet/personat në nevojë/fëmijët/viktimat e dhunës; (d) Përmirësimi i infrastrukturës në institucione/investime publike/hapësira publike për kategoritë në nevojë.

3. Zgjerimi i hartës së shërbimeve sociale në Bashkinë Kamëz.

Masat e parashikuara përfshijnë: (a) Zhvillimi i partneriteteve me OJF; (b) Zgjerimi me shërbime të reja të ofruara në bashkinë Kamëz në bashkëpunim me OJF; (c) Zgjerimi me përfshirjen aktive të komunitetit në shërbime sociale; nxitja e vullnetarizmit në ofrimin e shërbimeve.

4. Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë.

Masat e parashikuara përfshijnë: (a) Mbështetja dhe fuqizimi i familjeve në nevojë; (b) Mbështetja dhe fuqizimi i grave kryefamiljare (veçanërisht nënat me shumë fëmijë të grupmoshave nën 18 vjeç); (c) Mbështetja dhe fuqizimi i komunitetit Rom dhe Egjiptian.

5. Zhvillimi i komponentit parandalues të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Masat e parashikuara përfshijnë: (a) Të rritet niveli i ndërgjegjësimit në komunitet; (b) Përfshirja e komunitetit në vendimmarrjet që lidhen me sistemin komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E NDIHMËS EKONOMIKE DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE

Për zbatimin e këtij Plani dhe përmbushjen e objektivave të tij, Bashkia Kamëz duhet të ngrejë Fondin Social për periudhën 2024-2026, në masën 287,712,804 lekë.

Për vitin e parë, Bashkisë i nevojitet 76.4% e buxhetit total të këtij Plani (219,964,268 lekë).

Për vitin e dytë, i nevojitet 11.8% e buxhetit total të këtij Plani (33,874,268 lekë).

Për vitin e tretë, i nevojitet 11.8% e buxhetit total të këtij Plani (33,874,268 lekë).

Për vitin e parë, Bashkia ka fonde të planifikuara, por jo në masën e nevojshme, për disa nga aktivitetet e parashikuara në Planin Social.

Buxheti që ajo ka tashmë për vitin e parë është 116,301,200 lekë. Në këto kushte hendeuku i financimit për vitin e parë është 103,411,604 lekë.

Drejtorja e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale do të identifikojnë vazhdimisht donatorë të mundshëm, për të mundësuar aplikimin dhe më pas mbështetje, për shërbimet që duhet të ngrihen në përputhje me Planin Social. Kjo do të mundësojë mbulimin e kostove të hendeikut financiar të krijuar për vitin e parë të zbatimit dhe në vazhdimësi.

Bashkangjitur do të gjeni:

- 1) Planin Social 2024-2026
- 2) Tabelën e Buxhetit

Duke shprehur në miratimin e këtij projekt-vendimi dhe duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Konceptoi:

Alltane DURA
Përgjegjëse e Sektorit të ndihmës ekonomike
Erina HALILI
Përgjegjëse e Sektorit të Paftësisë
Gilma BAJRAMAJ
Përgjegjëse e Sektorit të Mbrojtjes Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore
Arjola GJUTA
Koordinatore e Dhunës në familje

Miratoi:

Drejtor/ Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale

Raimonda NIKOLLI



This project is funded
by the European Union



Linja e Këshillimit
për Gra dhe Vajza

116 117



PLANI SOCIAL BASHKIA KAMËZ

Plani Social 2024-2026
i Bashkisë Kamëz u përgatit me kontributin
e Organizatës “Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza”.



Disclaimer

Ky publikim është prodhuar nga Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza me mbështetjen financiare të Bashkimit European. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e "Linjës së Këshillimit për Gra dhe Vajza" dhe nuk përfaqëson detyrimisht qëndrimin zyrtar të Bashkimit European.

PËRMBAJTJA

Lista e tabelave dhe grafikëve.....	5
Tabela e shkurtimeve	6
HYRJE	7
METODOLOGJIA	9
1. MISIONI, VIZIONI, PARIMET UDHËRRËFYESE DHE MONITORIMI	12
1.1 Misioni.....	12
1.2 Vizioni.....	12
1.3 Parimet udhërrëfyese.....	12
2. ANALIZA E SITUATËS SË GRUPEVE NË NEVOJË DHE SHËRBIMEVE EGZISTUESE.....	15
2. 1 Të dhëna demografike	15
3. PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA.....	22
3.1 : Të dhëna demografike.....	22
3.2 Kujdesi shëndetësor.....	25
3.3 Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim.....	26
3.4 Punësimi i PAK	27
3.5 Shërbimet zhvilluese dhe rehabilituese sociale.....	28
4. FËMIJË NË NEVOJË PËR MBROJTJE DHE PËRKUJDESJE	31
Madhësia e grupit dhe shtrirja në territor.....	31
VIKTIMA TË DHUNËS NË FAMILJE.....	37
5.1 : Sektori i dhunës në familje	37
5.2 Shërbimet për viktimat e dhunës në familje	40
5.3 Këshillimi ligjor dhe shërbimi psikosocial.....	44
6. ROMET DHE EGJIPTIANËT	46
7. TE MOSHUARIT NË NEVOJË PËR SHËRBIME	48
8. PËRDORUESIT E DROGËS	49
9. ANALIZA SWOT	50
9.1 Pikat e forta.....	50
9.2 Pika të dobëta	52
9.3 Mundësitë.....	53
9.4 Rreziqe.....	54
10. Prioritetet	55

11. QËLLIMET, OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET.....	57
12. MONITORIMI DHE VLERËSIMI	80
13. PËRMBLEDHJE E BUXHETIT.....	81
REFERENCAT	82
SHTOJCA 1: Numri i familjeve që trajtohen me NE nga fondet e bashkisë, Shtator-Tetor 2023 ..	85
SHTOJCA 2: Tabela përmbledhese e programimit të fondit të Paaftësisë për vitin 2024	86
SHTOJCA 3: Numri i familjeve të hyra dhe të dala nga skema e ndihmës ekonomike, Shtator-Tetor 2023	89
SHTOJCA 4: Familje në NE me shumë fëmijë, me fëmijë jetimë dhe kryefamiljarë përfitues të kompensimit të energjisë elektrike, Shtator-Tetor 2023	90
SHTOJCA 5: Tabela mbi numrin e familjeve, individëve përfitues të skemës së ndihmës ekonomike si dhe fondet faktike të shpenzuara, Shtator-Tetor 2023	91
SHTOJCA 6: Numri i familjeve dhe individëve në ndihmë ekonomike me fëmijë 0-15 vjec, Shtator-Tetor 2023	93
SHTOJCA 7: Formularët e raportimit për fëmijët.....	94
SHTOJCA 8: Model i raportit periodik të monitorimit të zbatimit të urdhrat të mbrojtjes.....	99
SHTOJCA 9: Formulari për informacionin e nevojshëm.....	103
SHTOJCA 10: Raport për Vlerësimin e Nevojave dhe ecurinë e PAK	110
SHTOJCA 11 . STRUKTURA AKTUALE PËRGJEGJËSE PËR MBROJTJEN DHE PËRKUJDESJEN SOCIALE	116

Lista e tabelave dhe grafikëve

<i>Tabela 1. Përmbledhje e numrit të popullsisë në Bashkinë Kamëz.....</i>	<i>Faqe 15</i>
<i>Tabela 2. Përmbledhje e individëve në nevojë për shërbime të identifikuara në raport me numrin e popullsisë.....</i>	<i>Faqe 16</i>
<i>Tabela 3. Familje në skemën e NE krahasuar me familjet sipas gjendjes civile.....</i>	<i>Faqe 17</i>
<i>Tabela 4. Shpërndarja e punëkërkuarve të papunë sipas karakteristikave.....</i>	<i>Faqe 18</i>

<i>Grafik 1: Përqindja e popullsisë sipas Lagjeve/Njësive Administrative.....</i>	<i>Faqe 15</i>
<i>Grafiku nr. 2: Numri i familjeve përfituese të NE.....</i>	<i>Faqe 17</i>
<i>Grafiku nr. 3: Nr. i punëkërkuarve sipas moshës.....</i>	<i>Faqe 19</i>
<i>Grafiku nr. 4: Individët PAK sipas njësisë/lagjeve administrative.....</i>	<i>Faqe 23</i>
<i>Grafiku nr. 5: Nr. I individëve PAK sipas kategorisë.....</i>	<i>Faqe 23</i>
<i>Grafiku nr. 6: Nr. I invalidëve të punës sipas lagjeve/njësive Administrative.....</i>	<i>Faqe 24</i>
<i>Grafiku nr. 7: Nr. I fëmijëve PAK sipas Lagjeve-Njësive Administrative.....</i>	<i>Faqe 26</i>
<i>Grafiku nr. 8: Rastet e menaxhuara të fëmijëve, viti 2022.....</i>	<i>Faqe 31</i>
<i>Grafiku nr. 9: Rastet e dhunës në familje ndër vite.....</i>	<i>Faqe 39</i>
<i>Grafiku nr. 10: Rastet e dhunës në familje të pajisura me UMM.....</i>	<i>Faqe 39</i>

TABELA E SHKURTIMEVE:

BK - Bashkia Kamëz
NE - Ndihma Ekonomike
NJA - Njësi Administrative
NJVNR - Njësi e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit
OJF - Organizata Jofitimprurëse
PAK - Personat me Aftësi të Kufizuar
PBA - Programi Buxhetor Afatmesëm
PMF - Punonjës për Mbrojtjen e fëmijës
DSHP - Drejtori e Shërbimeve Publike
DRSHSSH - Drejtori Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror
DSS - Drejtoria e Strehimit Social
DPI - Drejtoria e Projekteve dhe Investimeve
AKPA - Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
BE/EU - Bashkimi European
ETN - Ekip Teknik Ndërdisciplinar
IKP - Indikatorët Kyç të Performancës
ISHSH - Inspektorati i Shërbimeve Shoqërore
MD - Ministria e Drejtësisë
MKR - Mekanizmi i Koordinuar i Referimit
MSHMS - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
PUPA - Punëkërkuar i papunë
RKSH - Regjistri Kombëtar i Shërbimeve
SHSSH - Shërbimi Social Shtetëror
UM - Urdhër Mbrojtje
UMM - Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtje
VKB - Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM - Vendim i Këshillit të Ministrave
ZP - Zyra e Punës

HYRJE

Plani Social i Bashkisë Kamëz i prezantuar në vazhdim është një dokument i bazuar në një qasje gjithëpërfshirëse i cili synon të adresojë nevojat për shërbime sociale, fuqizimin e strukturave përgjegjëse vendore, si dhe përmirësimin e shpërndarjes dhe llojshmërisë së shërbimeve.

Plani është hartuar përmes një procesi konsultimi me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse vendore, shoqërisë civile, ofrues të shërbimeve si dhe grupeve në nevojë, për të garantuar një vlerësim sa më afër nevojave reale të tyre dhe mundësive për ti adresuar këto nevoja tek aktorët e duhur.

Reforma e re administrativo-territoriale ka sjellë një sërë ndryshimesh në kompetencat e njësive të qeverisjes vendore në shtrirje, krijimin dhe administrimin e shërbimeve në nivel vendor.

Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore” ka ngarkuar njësitë e qeverisjes vendore me një sërë përgjegjësish të reja e të rëndësishme në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, duke qenë se për shkak të afërsisë me komunitetin, niveli vendor konsiderohet si më i përshtatshmi për ofrimin e shërbimeve shoqërore për përfituesit. Këto shërbime përfshijnë ofrimin e shërbimeve shoqërore komunitare, shqyrtimin dhe vendimmarrjen në lidhje me procedurat për marrjen në kujdestari, si dhe, në raste të caktuara, menaxhimin e shërbimeve rezidenciale. Po kështu, legjislacioni përcakton detyrimet specifike për shërbimin shoqëror në nivel vendor.

Shërbimet e kujdesit shoqëror konsiderohen si funksion i vetë pushtetit vendor, sipas Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (2023-2030), në përputhje me ligjin për vetëqeverisjen vendore. Strategjia synon konsolidimin e mëtejshëm të procesit të decentralizimit për një zhvillim ekonomik vendor të qëndrueshëm me shërbime cilësore, gjithëpërfshirëse për qytetarët dhe transparente drejt standardeve evropiane. Ky qëllim kryesor synohet të arrihet duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm vendor me anë të rritjes së kapaciteteve vendore për menaxhim të integruar të aseteve vendore, përmirësuar ofrimin e shërbimeve vendore me qëllim rritjen e cilësisë së ofrimit të tyre dhe me standard tek qytetarët, digjitalizimin e shërbimeve vendore dhe përmirësimin e infrastrukturës së ofrimit të tyre, rritjes së autonomisë financiare vendore nëpërmjet konsolidimit të sistemit të ardhurave të veta, përmirësimit të demokracisë vendore dhe avancim i agjendës së integritetit evropian në nivel vendor si dhe konsolidimit të mëtejshëm të kapaciteteve të strukturave administrative në mbështetje të qeverisjes vendore.

Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2020-2023 adreson objektiva të qartë dhe të matshëm për mbrojtjen sociale në Shqipëri. Kjo strategji gërsheton politika dhe programe specifike për të reduktuar varfërinë, duke zvogëluar ekspozimin e familjeve dhe popullatës/njerëzve ndaj rreziqeve dhe duke rritur kapacitetin e tyre për të mbrojtur veten nga rreziqet dhe mungesën e të ardhurave. Gjithashtu, strategjia propozon ndërhyrje prioritare nëpërmjet zbatimit të programeve të ndihmës ekonomike, sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore e shëndetësore, duke përfshirë mbrojtjen e familjeve, fëmijëve dhe popullatës bazuar në skema makro (në nivelkombëtar) dhe në nivel mikro (në nivel bashkie, qyteti, fshati, komuniteti, familje), si



dhe procesin e rikthimit drejt tregut të punës me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës për çdo individ dhe familje.

Bazuar në sa më lart dhe mënyrën e funksionimit të sistemit të ri të kujdesit shoqëror, MSHMS zhvillon politikat dhe përcakton prioritetet, por nga ana tjetër bashkitë kanë përgjegjësinë kryesore për planifikimin dhe buxhetimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në territorin e tyre.

Në këtë kuadër, Bashkia e Kamzës ka marrë përsipër hartimin e Planit Social, të prezantuar në këtë dokument. Plani është bazuar në qasjen e ofrimit të një pakete shërbimesh për të gjitha kategoritë e grupeve në nevojë dhe në filozofinë e ndërtimit të partneritetit midis aktorëve të ndryshëm, si institucionet e qeverisjes vendore dhe rajonale, organizatat ndërkombëtare, kombëtare dhe ato vendore, si dhe biznesin vendor si një mbështetës potencial në fuqizimin e shërbimeve sociale.

Plani Social synon të përmirësojë mirëqenien fizike, shoqërore dhe ekonomike të individëve, fëmijëve dhe familjeve, veçanërisht të atyre në kushte sociale ose ekonomike të pafavorizuara, duke garantuar shanse të barabarta dhe parimet e drejtësisë sociale. Ndër të tjera synon reduktimin e varfërisë, sidomos varfërisë ekstreme, duke garantuar një jetesë dinjitoze për familjet/individin dhe fëmijët, duke nxitur zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive të tyre nëpërmjet adresimit të nevojave në kontekstin e rehabilitimit, integritetit në tregun e punës dhe të shërbimeve shoqërore.

Ne synojmë të zhvillojmë një sistem të integruar funksional të shërbimeve të kujdesit shoqëror për çdo individ që promovon zgjedhjen, pavarësinë dhe inkurajon pjesëmarrje të plotë dhe efektive në shoqëri, sipas një qasjeje të barabartë për të gjithë qytetarët që kërkojnë shërbime.

METODOLOGJIA

Për hartimin e Planit Social, konsulentët punoi bashkë me grupin lokal të Bashkisë Kamëz e përbërë nga Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale. Në fazën e parë grupi punoi për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Nevojave për Shërbime të Kujdesit Shoqëror, i cili mundësoi identifikimin e grupeve vulnerabël, nevojave të tyre për shërbime dhe se sa dhe si përmbushen ato përmes shërbimeve ekzistuese. Për të mundësuar këtë raport grupi përdori teknika të ndryshme të kërkimit:

1. Analiza e kuadrit strategjik dhe dokumenteve të tjera

Politikat lokale në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror e kanë rrënjën e tyre tek politikat dhe standardet kombëtare. Politikat kombëtare janë parashikuar në strategjitë kombëtare që lidhen drejtpërdrejtë me mbrojtjen shoqërore apo me aspekte të ndryshme të saj. Në këto strategji Qeveria Qendrore ka përcaktuar sfidat, vizionin e saj strategjik, objektivat si dhe politikat për mbërritjen e tyre. Strategjitë janë të mbështetura me planet e tyre të veprimit, treguesit e arritjeve, si dhe me parashikimet për burimet financiare që duhen për realizimin e tyre. Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2020-2023 është strategjia kryesore orientuese për hartimin e Planit Social Vendor, ndërkohë që një seri dokumentesh të tjera strategjike janë të lidhura dhe të harmonizuara me të si Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, Strategjia e Përfshirjes Sociale, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, Strategjia për Punësim dhe Aftësim, Strategjia për Strehimin Social etj. Një pjesë e këtyre Strategjive e kanë përfunduar afatin e zbatimit të tyre në 2020, por misioni dhe objektivat e tyre janë të vlefshme edhe për të ardhmen, ndërsa një pjesë e veprimeve të parashikuara mbeten për tu bartur në dokumentet e ardhshme që pritet të hartohen.

2. Analiza e kuadrit ligjor

Analiza e legjislacionit kombëtar ndihmoi në katër drejtime kryesore: (i) listimin paraprak të grupeve të mundshme në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror. Paketa ligjore e analizuar ka përkufizuar grupet në nevojë për shërbime. Mbi bazën e tyre u ndërtua më pas kërkimi përmes treguesve socialë dhe administrativë, si dhe konsultimeve të zhvilluara për të identifikuar se cilat janë grupet në nevojë për shërbime, si dhe karakteristikat e tyre; (ii) shporta e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Analiza ndihmoi për të identifikuar tipet e shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe standardet specifike të tyre. Analiza



lehtësoi vlerësimin e shërbimeve egzistuese, sikurse dhe planifikimin e shërbimeve që duhet të ngrihen në territorin e Bashkisë; (iii) llojet e shërbimeve, standardet e ofrimit të tyre si dhe procedurat në rastet e dhunës në familje; (iv) strukturat dhe organizimi i Bashkisë në të dy nivelet e saj. Analiza e legjislacionit në këtë këndvështrim është udhërrëfyese për të rishikuar në përputhje me kuadrin ligjor rolet dhe funksionet e Bashkisë në këtë fushë, si dhe burimet njerëzore që duhet të planifikojë për të përmbushur cilësisht këto role e përgjegjësi që i ka dhënë legjislacioni kombëtar. U konsultua gjithashtu Planit Social 2020-2023 i Bashkisë Kamëz, si dhe Rregullorja e Brendshme e Bashkisë, kjo e fundit për të identifikuar rolet dhe funksionet jo vetëm të strukturave egzistuese në Bashki në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, por edhe të njësive të tjera brenda Bashkisë me të cilat duhet ndërvepruar gjatë fazës së përgatitjes së Planit Social, si dhe duhen përfshirë më pas në fazën e zbatimit dhe monitorimit të Planit.

3. Treguesit socialë dhe administrativë

U identifikuan dhe u mbledhën një numër treguesish socialë dhe administrativë, të cilat lehtësuan identifikimin e grupeve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, karakteristikat e tyre, madhësinë, territorin ku ata jetojnë, si dhe shërbimet egzistuese të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë dhe në Qarkun Tiranë. U identifikuan dhe u mbledhën një numër të dhënash statistikore dhe jo statistikore nga institucione kombëtare dhe lokale, si: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Administratorët shoqëror dhe të dhëna të Rregjistrat Elektronik Kombëtar të Ndhmës Ekonomike, Zyra e Punës, Strukturat Arsimore dhe Shëndetësore në Kamëz, si dhe Policia. Të dhënat u mbledhën në periudhën Tetor-Nëntor 2023.

4. Takime me stafin e Bashkisë, institucione publike dhe ofrues shërbimesh

Pas analizës së të dhënave të mbledhura u zhvilluan takime me: (1) Stafin e Drejtorisë së Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale në Bashki dhe në katër njësitë/lagjet e saj. (2) Përfaqësues të institucioneve që në përputhje me ligjin kanë role e përgjegjësi për adresimin e nevojave të disa prej grupeve vulnerabël, arsim, zyra e punës, shëndetësi dhe polici. (3) Ofrues shërbimesh publik në territorin e Bashkisë, Qendra Komunitare Multifunkionale për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Pavarësisht nga përpjekjet për të identifikuar të gjitha grupet në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror dhe nevojat e tyre për shërbime, vlerësojmë se analiza e grupeve në nevojë për shërbime ka kufizime që rrjedhin nga: (1) Mungesa e të dhënave zyrtare për disa grupe në nevojë, që edhe pse përfaqësuesit e institucioneve i cilësuan si grupe në nevojë për shërbime, nuk rregjistrojnë të dhëna për ta. Të tilla janë kryesisht të dhënat për të moshuarit në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, apo për përdorues të



mundshëm të alkoolit apo drogës për të cilat mungojnë të dhëna të rregjistruara nga institucionet; (2) Analiza mbi shërbimet egzistuese u mbështet tek partneriteti egzistues i Bashkisë me ofruesit jopublik, por në territor mund të ketë shërbime të tjera jopublike apo programe të zbatuara nga organizata joqeveritare të paidentifikuara. (3) Raporti nuk mundëson një pamje të plotë mbi situatën e grupeve vulnerabël parë nga këndvështrimi gjinor, pasi për disa prej grupeve të analizuara mungojnë të dhëna të ndara sipas gjinisë.

1. MISIONI, VIZIONI, PARIMET UDHËRRËFYESE DHE MONITORIMI

1.1 Misioni

Bashkia Kamëz do të garantojë, zgjerojë e konsolidojë shërbime komunitare të kujdesit shoqëror në përputhje me standartet kombëtare, për të përmirësuar jetën e çdo individi në situatë të pafavorshme, të përjashtuar ose në rrezik përjashtimi, duke siguruar mbrojtjen, përfshirjen dhe integrimin shoqëror të tyre.

Për të përmbushur këtë mision Bashkia do të alokojë burime të nevojshme njerëzore, materiale dhe financiare, si dhe do të zhvillojë më tej partneritetin me institucione e ofrues shërbimesh publik e jo publik që ndajnë detyrime e vizione të përbashkëta me të kundërt grupeve në nevojë për mbrojtje e përkujdesje.

1.2 Vizioni

Krijimi i një sistemi komunitar të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror, i zgjeruar, i konsoliduar dhe funksional, që garanton mbrojtje, zhvillim, pavarësi, pjesëmarrje në jetën e komunitetit për çdo individ që i ka të nevojshme këto shërbime.

1.3 Parimet udhërrëfyese

Sistemi komunitar i shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë Kamëz do të vijojë të krijohet, e zgjerohet në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe parimet universale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë në bazë të këtyre parimeve themelore:

Parimi i universalitetit

Shërbimet e kujdesit shoqëror do të krijohen, funksionojnë dhe mbikëqyren bazuar në sistemin kombëtar të rregullave dhe standardeve që ofrojnë garanci të mjaftueshme për t'u zbatuar në mënyrë të njëjtë për përfituesit që ndodhen në të njëjtat kushte. Përveç ngritjes dhe funksionimit të çdo shërbimi sipas standardit kombëtar të miratuar, Bashkia përmes strukturës përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror do të monitorojë në mënyrë periodike përmbushjen e tyre nga ofruesit e shërbimit të ngritur apo financuar plotësisht ose pjesërisht nga Fondi Social i Bashkisë.

Parimi i deinstitutionalizimit

Shërbimet e kujdesit shoqëror do të sigurohen dhe ofrohen me prioritet pranë familjes ose komunitetit të përfituesit të shërbimit. Shërbimi komunitar do të prevalojë mbi shërbimin rezidencial. Në rastet kur individit për shkaqe dhe rrethana specifike do të vendoset në shërbim rezidencial strukturat përgjegjëse do të punojnë për qëndrim sa më të shkurtër në shërbimin rezidencial dhe rikthimin e tij në komunitet. Aty ku është e mundur, sipas planeve individuale, do të fuqizohen familjet biologjike në një plan të plotë mbështetjeje, me synimin për të kthyer fëmijët pranë tyre, rast pas rasti.

Parimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe integritetit të përfituesit

Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror do të bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut, integritetit të individit, besimit fetar dhe formimin e gjithanshëm të tij. Individët janë përgjegjës për jetën e tyre, prandaj do të inkurajohen që të marrin vendime për jetën e tyre gjatë gjithë kohës që marrin shërbime të kujdesit shoqëror.

Parimi i mosdiskriminimit

Bashkia është e angazhuar për të mos lejuar asnjë formë të diskriminimit të përfituesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në shkaqet e përmendura në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Parimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale

Të dhënat personale të individit, që trajtohet me shërbime të kujdesit shoqëror, janë konfidenciale dhe do të mbrohen e përpunohen sipas ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Punonjësi social, si dhe çdo person tjetër i angazhuar në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror do të ruaj konfidencialitetin e të dhënave personale të individit, për të cilin ka marrë dijeni si pasojë e funksionit apo detyrës që kryen.

Parimi i drejtësisë sociale dhe mbështetjes shoqërore

Bashkia Kamëz është e angazhuar që, për individët që përmbushin kushtet për të përfituar nga shërbimet e kujdesit shoqëror, të respektojë të drejtën e tyre për të marrë shërbimet në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe për aq kohë sa janë në kushtet e të drejtës për të përfituar shërbimet.



Parimi i partneritetit


Funksionimi i sistemit të shërbimeve shoqërore në Bashkinë Kamëz do të bazohet në një bashkëpunim të ngushtë midis qeverisjes qendrore dhe vendore, si financues kryesorë të shërbimeve shoqërore. Bashkia është e angazhuar të zhvillojë partneritetin aktual me organizatat që punojnë për mbështetjen e grupeve në nevojë dhe respektimin e të drejtave të tyre, si dhe ta zgjerojë këtë partneritet me çdo organizatë, donatorë, grup interesi apo biznese lokale qëllimet dhe objektivat e të cilave përputhen me ato të këtij Plani Social.

2. ANALIZA E SITUATËS SË GRUPEVE NË NEVOJË DHE SHËRBIMEVE EGZISTUESE

2. 1 Të dhëna demografike

Bashkia Kamëz ka një popullsi prej 147,721 banorësh ², pjesë e 40,586 familje. Mesatarja e pjesëtarëve të një familje në këtë Bashki është 3,63 banorë. Bashkia ka një sipërfaqe prej 37.18 km² dhe në bazë të regjistrit civil densiteti i popullsisë është 3973,13 banorë/km².

Bashkia përbëhet nga Njësi Administrative Paskuqan, Lagjia Administrative nr.2 Kamëz, Lagjia Administrative Nr. 1 Valias, dhe Lagjia Administrative Bathore. Në njësinë administrative Kamëz është regjistruar 65.5% e popullsisë dhe 34.5% e saj është regjistruar në Paskuqan.



Njësia	Numri	Numri
Administrative	Popullsisë	Familjeve
Kamëz	96646	26237
Paskuqan	51075	14349
TOTALI	147721	40586

Në tabelën numër një paraqitet numri i popullsisë për Njësinë Administrative Paskuqan dhe Lagjia Administrative nr.2 Kamëz.

Në Lagjia Administrative nr.2 janë në total 26,237 familje dhe në Njësinë Administrative Paskuqan janë në total 14,349 familje.

Tabela 1. Përmbledhje e numrit të popullsisë në Bashkinë Kamëz

2.2 Individë në nevojë për shërbime sipas të dhënave statistikore dhe administrative

Analiza e grupeve në nevojë identifikoi 6,605 individë, të cilët janë përfshirë në vit në sistemin e mbrojtjes dhe kujdesit social të Bashkisë Kamëz. Duke ju referuar numrit të përgjithshëm të popullsisë të regjistruar në gjendjen civile rezulton se është 4.47% e popullsisë që ka nevojë për të paktën një nga format e shërbimeve të pagesave të mbrojtjes sociale apo shërbimeve komunitare të kujdesit shoqëror. Peshën kryesore në totalin e identifikuar e kanë individët pjesë e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike

² Të dhëna të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, Janar 2020

dhe personat me aftësi të kufizuara që përfitojnë pagesa cash, një pjesë e të cilëve është e përfshirë edhe në shërbimet fuqizuese apo rehabilituese.

67% e individëve të identifikuar në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror janë të rregjistruar në njësine administrative Kamëz dhe 33% e individëve të identifikuar janë të rregjistruar në njësine administrative Paskuqan.

NJËSIA ADMINISTRATIVE	NR. POPULLSIE	NR. INDIVIDË NË NEVOJË PËR SHËRBIME KUJDESI SHOQËROR	%
Kamëz	96,646	4425	4,5%
Paskuqan	51,075	2180	4.2%
TOTALI BASHKI	147,721	6605	4.47%

Tabela 2. Përmbledhje e individëve në nevojë për shërbime të identifikuara në raport me numrin e popullsisë

Treguesit socialë e administrativë, fokus grupet dhe intervistat e zhvilluara me punonjësit social të Bashkisë Kamëz, identifikuan këto grupe kryesore në nevojë për shërbime sociale: (1) Familje pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme, (2) persona me aftësi të kufizuara, (3) viktimat të dhunës në familje, (4) fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje, (5) familje romë dhe egjiptiane, (6) të moshuar në nevojë për shërbime, (7) viktimat trafikimi. Madhësia e çdo grupi dhe shtrirja në territor është analizuar gjerësisht në seksionet vijuese. Pavarësisht përpjekjes për të qenë sa më shterues në identifikimin e grupeve dhe madhësisë së tyre, mungesa e të dhënave të mbledhura dhe të regjistruara sistematikisht për rastet e menaxhuara apo rastet që kanë kërkuar shërbime, edhe atëherë kur shërbimet mungojnë, lë vend për pasaktësi. Aktualisht, në Bashkinë e Kamëz, po punohet mbi sistemin SHKSH ku dotë bëhet regjistrimi sistematik i të dhënave të grumbulluara për individët në nevojë për shërbime.

Analiza për secilin grup në nevojë të identifikuar pasqyron shërbimet egzistuese dhe nivelin e përfshirjes së secilit grup në këto shërbime. Analiza në vijim tregon se ka një boshllëk mes nevojës për shërbime sociale dhe masës që kjo nevojë adresohet përmes shërbimeve.

Në Bashkinë Kamëz, 496 familje përfituan ndihmën ekonomike në tetor 2023³ përmes skemës kombëtare, 64 familje u trajtuan përmes fondit 6%, ndërkohë 76 familje u trajtuan përmes fondit lokal të bashkisë, pasi kishin kushte mjaft të vështira sociak-ekonomike dhe shëndetësore. Referuar numrit të përgjithshëm të familjeve në këtë Bashki, 40,586 familje, rezulton se 1,5% e popullsisë ka të ardhura të pamjaftueshme për të përballuar jetesën.

³ Të dhëna të Rregjistrimit Elektronik Kombëtar të ndihmës Ekonomike, tetor 2023

Siç shihet nga grafiku 2, përqindja më e lartë e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike jeton në Lagjen Bathore (44.1%).

Në Raport me numrin e familjeve të rregjistruara në gjendjen civile, siç shihet në tabelën 3, sërisht Bashkia Kamëz që përfshin Lagjen administrative

Bathore, Lagjen administrative Nr. 1, Lagjen administrative Nr. 2 shënon nivelin më të lartë të varfërisë. Në këtë njësi 2.1% e familjeve përfiton ndihmën ekonomike, ndërsa në njësinë administrative Paskuqan 0,16% e familjeve përfiton këtë ndihmë financiare.

Grafiku nr. 2: Numri i familjeve përfituese të NE




Tabela 3. Familje në skemën e NE krahasuar me familjet sipas gjendjes civile

Njësia administrative	Familje gjendje civile	Familje përfituese të ndihmës ekonomike	Familje përfituese nga fondi 6%	% (familje NE/totalit familje)
Kamez	26,237	419	56	1.59%
Paskuqan	14,349	77	8	0.53%
TOTALI	40,586	496	64	1.5%

Nga krahasimi i të dhënave për dy vite, 2022 dhe 2023, vihet re se ka një ulje me 9% të numrit të familjeve aplikuese për ndihmë ekonomike. Në dhjetor 2022 aplikuan për ndihmë ekonomike 611 familje, ndërsa në tetor 2023 aplikuan për ndihmë 593 familje. Skema është ulur me 0.9% në tetor 2023 krahasuar me dhjetorin e vitit 2022. Nga intervistat me administratorët shoqërorë nxorren në pah faktin që ulja e numrit të përfituesve ka ardhur si rezultat i punësimit nga programi i nxitjes punësimit në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe zyrën e punës.

Në vijim jepen grafikisht grupet në nevojë për shërbime dhe shërbimet egzistuese të identifikuar në territorin e Bashkisë.

Janë 2200 individë në familjet përfituese të ndihmës ekonomike: 1084 fëmijë të grupmoshës 0-18 vjeç (49.2% e përfituesve), 1030 individë të grupmoshës 19-64 vjeç (46.8% e përfituesve) dhe 86 individë të grupmoshës mbi 65 vjeç (4% e përfituesve). Numri mesatar i pjesëtarëve në familjet përfituese të ndihmës ekonomike është 3,4 anëtarë.

120 familje përfituese të ndihmës ekonomike (19% e tyre) kanë të paktën një pjesëtar me aftësi të kufizuara.

Janë 41 familje rome-egjiptiane që përfitojnë ndihmën ekonomike, ose 11.2% e përfituesve të kësaj skeme.

Numri i individëve viktimë të dhunës në familje që janë trajtuar me NE ka patur rënie referuar viteve 2021 dhe 2022. Kanë qenë 149 individë në 2021, 106 individë në vitin 2022 dhe vetëm 75 në vitin 2023.

Janë 129 gra kryefamiljare (20% e totalit të grave përfituese) përfituese të ndihmës ekonomike. Shqetësim mbetet për administratorët shoqëror fakti që nga skema kombëtare vijnë të mbeten jo përfituese edhe familje që kanë gruan kryefamiljare. Ato trajtohen përmes fondit 6%, por ky fond nuk është i mjaftueshëm për të trajtuar edhe të tjera familje që janë të varfëra dhe që nuk arrijnë të fitojnë ndihmën ekonomike përmes sistemit kombëtar dhe shume prej tyre trajtohen nga fondet e bashkisë.

Në fakt në Zyrën e Punës ⁴ rezultojnë të rregjistruara për punë 2926 punëkërkues të papunë nga të cilët 1636 femra, të cilat përbëjnë 56% të punëkërkuesve të papunë në këtë Bashki dhe 44% e punëkërkuesve të regjistruar janë meshkuj.

Vihet re që gratë dhe vajzat pa arsim të rregjistruara si punëkërkuese zënë 8.4% të totalit, me arsim fillor 8.6% të tyre, të mesëm 73.4%.

Aktualisht, figurojnë 750 punëkërkues të papunë njëkohësisht përfitues të NE (rreth 26% e totalit PUPA), nga të cilët 3.2% e punëkërkuesve janë romë dhe egjiptianë. Sektori i ndihmës ekonomike ka bërë të mundur rregjistrimin e familjeve rome dhe egjiptiane në territorin e Bashkisë Kamëz. Të dhënat e tyre japin 329 familje të tilla. Mes familjeve rome që aplikojnë për ndihmë ekonomike ka familje që nuk arrijnë ta përfitojnë atë për shkak të mos pranimit të ofertës së punës ose mosparaqitjes në Zyrën e Punës.

Tabela 4: Shpërndarja e punëkërkuesve të papunë sipas karakteristikave


Njesia Administrative	Total	Femra	Meshkuj	Kryefamiljar	Rom	Egjiptian	PAK	pa arsim	fillor	I mesem
Paskuqan	644	338	306	226	4	2	10	36	52	466
Kamëz	2282	1298	984	873	32	24	90	212	200	1679
Bashkia Total	2926	1636	1290	1099	36	26	100	248	252	2145

Ka një nivel të ulët të rregjistrimit si punëkërkues të papunë të personave me aftësi të kufizuar të cilët zënë etëm 3.4% të personave me aftësi të kufizuara të grupmoshës 18-64 vjeç.

⁴ Të dhëna të tetorit 2023

26% e grupmoshës aktive për punë që përfiton ndihmë ekonomike është në kërkim të një pune. Nga të dhënat vihet re se përqindjen më të madhe të punëkërkuësve e zë grupmosha 15-29 vjeç e cila zë 26% të totalit pasuar me pas nga grupmosha 36-45 vjeç e cila zë 21% të punëkërkuësve të rregjistruar pranë zyrës së punës.

Grafiku nr. 3: Nr. i punëkërkuësve sipas moshës



Prej muajit Prill 2022, po zbatohet sistemi i përmirësuar i shërbimeve të punësimit, i cili bën të mundur nxjerrjen e më shumë informacioneve për punëkërkuësit e papunë. Ne bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të shërbimit Social Shtetëror dhe Zyrës Punës, Administratorët shoqëror kanë referuar për punësim mbështetur nga Programi i Nxitjes së punësimit të gjithë kategoritë e afta për punësim nga të cilët janë punësuar 43 individë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike dhe kanë ndjekur një kurs formimi profesional 9 punëkërkuës të papunë në NE, 6 prej të cilëve meshkuj dhe 3 femra.

Programi i nxitjes së punësimit ka patur si qëllim fuqizimin e familjeve përfituese të NE, pa i përjashtuar nga skema për një periudhë kohore 1 vjeçare.

Shumë individë të familjeve përfituese të NE refuzojnë ofertat e punës. Rezulton që, një nga arsyt kryesore për refuzimin e ofertave të punës dhe rezistencës për të qëndruar në skemën pasive, lidhet me përfitimet shtesë të atyre që kanë “statusin” e përfituesit të NE. Të tilla përfitime lidhen jo vetëm me përfitimet bazë (përfitimi bazë për secilin anëtar; kompensimi i energjisë; pagesa e shkollës së fëmijëve deri në klasën e IX), por edhe me të tjera përfitime sipas rastit (përjashtim nga pagesat për çerdhe dhe kopshte; përjashtim nga pagesat për vaksina; librat falas deri në klasë të XII; bursa për në universitet; përjashtim nga taksa lokale e kombëtare; kushte lehtësuese për aplikime në fonde të ndryshme shtetërore; zbritje të tarifave në proceset legalizuese, etj.), si një sërë përfitimesh që vijnë nga skema të ndryshme.

Në bazë të udhëzimit Nr. 670, datë 13.12.2022, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për Proçedurën e aplikimit dhe përfitimit nga programi i mbrojtjes së veçantë nga shteti, për gratë e papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç, u mbulua subvencioni nga shteti për pagesat e sigurimit të detyrueshëm shoqëror dhe shëndetësor.

Ndër të tjera për nënat që kanë fëmijë të mitur, nëse para disa vitesh sfida kryesore raportohet të ketë qenë pamundësia për të pranuar ofertat e punës, pasi mungesa e shërbimeve (kopshteve dhe çerdheve) e bënte të pamundur kujdesin ndaj fëmijëve të tyre në kohën që ato janë në punë, sot ky problem është i zgjidhur sepse aktualisht në bashkinë Kamëz ka 20 kopshte dhe 5 çerdhe me standarte dhe kushte bashkekohore, me ushqim dhe orar të përshtatshëm për nënat e punësuar. Të gjithë fëmijët, familjet e të cilëve janë pjesë përbërëse e programeve të strehimit, skemës së ndihmës ekonomike apo janë me probleme social-ekonomike i përfitojnë të gjithë shërbimet që ofrohen në kopshte dhe çerdhe pa asnjë kosto monetare.

Mbështetur në vendimin e Këshillit Bashkiak Kamëz “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz”, të gjithë familjet përfitues të ndihmës ekonomike janë të përjashtuara nga pagesat e taksave dhe tarifave vendore.

Bashkia Kamëz ka në prioritet familjet me probleme sociale-ekonomike dhe shëndetësore, si familjet me NE, jetimët, gratë e divorcuara, emigrantët, komunitetin egjiptian dhe rom, policët e rënë në detyrë, çiftet e reja, PAK, etj, duke siguruar që ata të kenë akses në strehim të përballueshëm. Numri i aplikuesve sipas këtyre kategorive varet nga vetëdeklarimet në fazën e parë të procesit, të cilat duhet të vërtetohen me dokumentacion në fazën e dytë.

Programet e zbatuara për strehimin gjatë vitit 2023 janë:

- Subvencionimi i bonusit të qerasë në tregun e lirë.
- Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistues
- Subvencionimi i interesave të kredisë

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Strehimit Social për vitin 2023 nga 480 familje që aplikuan për strehim social në Bashkinë Kamëz, 327 janë shpallur përfitues, prej të cilëve 58 familje ishin përfituese të programit të NE (17.7% e totalit të aplikimeve për strehim), 40 familje që kanë në përbërje persona me AK (12.2% e totalit të aplikimeve për strehim), 57 të moshuar (17.4%) dhe 5 gra viktime të dhunës në familje.

Prioritet mbeten pikat e mëposhtme:


- Ngritja e Njesisë së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave
- Ndërgjegjësim dhe informim i vazhdueshëm i pjesëtarëve të familjeve përfituese të NE mbi faktin që përfitimi i ndihmës ekonomike është masë e përkohëshme dhe punësimi është rruga e vetme për të mundur fuqizimin ekonomik të familjeve.
- Ndërveprim i vazhdueshëm mes çdo Administratori shoqëror dhe Referimi me Zyrën e Punës së Agjensisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive si dhe DRSSHSH për të



nxitur referimin për punësim të individëve në moshë pune të familjeve përfituese të NE.

- Zgjerimi i rrjetit të ofruesve të shërbimeve dhe organizatave.
- Zgjerimi i shërbimeve për komunitetin rom/egjiptian dhe për të moshuarit e vetmuar.

GRUPET NË NEVOJË DHE SHËRBIMET EGZISTUESE TË IDENTIFIKUARA/ DHJETOR 2020



3. PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA

3.1 : Të dhëna demografike

Bashkia Kamëz i ka kushtuar vëmendje të veçantë kategorisë vulnerabel që banon në territorin administrativ të bashkisë dhe veçanërisht personave me aftësi të kufizuara.

Krijimi i një mjedisi pa barriera ofron dhe krijon një shoqëri gjithëpërfshirëse. Vitet e fundit Bashkia Kamëz ka patur prioritet projektimin dhe ndërtimin e një mjedisi urban që i përshtatet çdo kategorie ndaj janë bërë të gjithë përpjekjet për ta projektuar qytetin në shërbim të të gjithë përdoruesëve duke siguruar kështu një ndërveprim social në jetën e banorëve. Kryesisht rrugët, trotuarët, institucionet arsimore, një pjesë e institucioneve shëndetësore dhe të gjithë objektet e ndërtuara rishtazi, janë tashmë të aksesueshme edhe nga personat me aftësi të kufizuara.

Nga ana tjetër Bashkia është pasive në identifikimin e individëve me aftësi të kufizuara, por trajton vetëm rastet kur individi PAK është paraqitur për të marrë shërbim. Çdo vendim për PAK del me pagesën e paaftësisë dhe shërbimet e nevojshme për t'u marrë nga individi.

Sipas ligjit të ri, administratori shoqëror duhet të bëjë vizita në familje çdo 3 muaj për individët PAK fizik dhe mendor. Aktualisht, administratori nuk bën ndonjë kryqëzim të informacionit midis skemave, siç do të ishte me interes lidhja familje me individ PAK - familje/individë përfitues të NE. Për më tepër, administratori nuk ka një instrument/formular të kontrollit në familje.

Për vitin 2023 në Bashkinë Kamëz janë 2088 persona me aftësi të kufizuara ndër të cilët:

- 978 (41.3%) femra dhe 1110 (58.7) meshkuj;
- 393 (19%) fëmijë;
- 1695 (81%) të rritur;

2088 individë ose 1,4% e popullsisë në Bashkinë Kamëz, janë vlerësuar nga komisionet mjekësore si individë që kanë të paktën një formë të aftësisë së kufizuar. Individët PAK janë të përfshirë në programin e pagesave të mbrojtjes sociale dhe kanë nevoja për shërbime rehabilituese apo zhvilluese në përputhje me tipin e aftësisë së kufizuar.


429 individë PAK (21%) janë të rregjistruar pranë sektorit PAK në Drejtorinë e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale.

249 individë (12%) të grupit të aftësisë së kufizuar janë të rregjistruar pranë sektorit PAK në Lagjen Administrative nr. 1 Valias-Laknas.

139 individë (7%) të grupit të aftësisë së kufizuar janë të rregjistruar pranë sektorit PAK në Lagjen Administrative nr. 2 Frutikulturë.

521 individë (25%) të grupit të aftësisë së kufizuar janë të rregjistruar pranë sektorit PAK në Lagjen Administrative Bathore.

720 persona (35%) të grupit të aftësisë së kufizuar janë të rregjistruar pranë sektorit PAK në Njësinë Administrative Paskuqan.




Grafiku nr. 4: Individët PAK sipas njësisë/lagjeve administrative

Grafiku nr. 5: Nr. I individëve PAK sipas kategorisë


Personat me aftësi të kufizuara të shëndetit mendor ose fizik zënë përqindjen më të lartë, specifikisht 1542 individë (74%) të grupit të aftësisë së kufizuar.

330 individë (16%) janë në kategorinë e të verbërve dhe 216 individë (10%) janë në grupin para-tetraplegjikë.

Nga individët me aftësi të kufizuar 632 (30%) prej tyre e kanë të nevojshme ndihmën personal referuar nivelit të aftësisë së kufizuar. Pavarësisht se në sistemin e pagesave janë të përfshirë dhe ndihmësit personal apo kujdestarët e individëve PAK, sfidat e këtij grupi janë më të mëdha brenda grupit të aftësisë së kufizuar në këndvështrimin e nevojave për shërbime dhe asistencë personale.



Grafiku nr. 6: Nr. I invalidëve të punës sipas Lagjeve/Njësive Administrative



Në Bashkinë Kamëz, 1538 invalidë pune (986 meshkuj dhe 552 femra), përveç pensionit të invaliditetit përfitojnë edhe një pagesë nga programi i mbrojtjes sociale. Numri më i madh i përket grupmoshës mbi 65 vjeç me 566 invalidë (36%). 993 invalidë pune (65% e totalit) jetojnë në njësinë administrative Kamëz ku: 335 invalidë pune jetojnë në territorin e Lagjes Administrative

Bathore; 79 invalidë pune jetojnë në territorin e Lagjes Administrative Nr. 2 Frutikulturë dhe 228 invalidë pune jetojnë në territorin e Lagjes Administrative nr. 1 Valias-Laknas. Në territorin e njësisë administrative Paskuqan jetojnë 545 invalidë pune (35% e totalit).

Në total në Bashkinë Kamëz janë 4,256 individë (2,8% e popullsisë) që përveçse janë të përfshirë në programin e pagesave të mbrojtjes sociale, kanë të nevojshme forma të ndryshme shërbimesh të kujdesit shoqëror që në parim duhet tu mundësojnë zhvillim, përfshirje dhe integrim në jetën komunitare. Nuk janë identifikuar raste të braktisjes së personave me aftësi të kufizuara nga familjarët e tyre.

Prej disa vitesh tashmë Bashkia Kamëz u përfshi në pilotimin e modelit të ri të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, vlerësim bio-psiko-social dhe tashmë ky model po zbatohet në të gjithë territorin e saj.

Vlerësimi bio-psiko-social bën të mundur përcaktimin e shkallës së prekjes së aftësisë për të realizuar, veprimtaritë bazë e ato të jetës së përditshme (që përfshin edhe aftësinë për punë) të grupuar në nivelet e lehtë, e moderuar, e rëndë dhe e plotë. Kjo lejon përcaktimin objektiv të nivelit të aftësisë së kufizuar, si edhe nevojat për shërbime të tjera si ndihmësi personal, paketa higjieno-sanitare, përkthyesi i gjuhës së shenjave, mjetet ndihmëse për lëvizje, etj. Pjesë e vlerësimit janë intervistat nëpërmjet të cilave komisioni bën vlerësimin për të krijuar profilin bio-psiko-social të përfituesit të aftësisë së kufizuar e më pas bën rekomandimet përkatëse në lidhje me përfitimet në pagesa dhe shërbimet shëndetësore, psiko-sociale, të arsimit, të formimit profesional dhe punësimit, strukturën familjare të personave me aftësi të kufizuara etj. Tashmë, vendimi i komisionit për personin me aftësi të kufizuar kombinohet me vendimin për përfitimin e pagesës së përmuajshme për aftësinë e kufizuar me cilësimin e shërbimeve që duhet të marrë individi në përputhje me nevojat e vlerësuara.

Nga ana tjetër ky model i ri i vlerësimit ka nxjerrë jashtë sistemit të pagesave cash një numër individësh për të cilët janë parashikuar vetëm përfitim shërbimesh. Përfitimi i shërbimeve të parashikuara sipas vendimeve të komisionit has pengesa për aksesin tek shërbimet ekzistuese si pasojë e distancës nga shërbimi apo mospërmblidhjes së kriterëve të aksesueshmërisë në përgjithësi. Gjithashtu, mungesa e disa shërbimeve i bëjnë një pjesë të konsiderueshme të këtyre vendimeve të pazbatueshme.



Një tjetër shqetësim i evidentuar për personat që kanë statusin e paraplegjikut dhe të verbërit është mosnjohja e të drejtës së tyre ligjore për akses falas në transportin publik. Në lidhjen e kontratës me operatorin privat nga ana e Bashkisë nuk është mbajtur në konsideratë kjo e drejtë, por Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale në bashkëpunim me Drejtorinë e Liçencave dhe Transportit pohojnë se do të zgjidhet edhe ky shqetësim. Nga ana tjetër transporti publik tashmë është mjaft i aksesueshëm për të gjithë personat me aftësi të kufizuara me audio, rampe dhe vënde të përcaktuara për invalidët.

3.2 Kujdesi shëndetësor

Në Bashkinë Kamëz ndodhen 13 qendra shëndetësore. Gjatë vitit 2021 nga qendra shëndetësore në Kamëz kanë marrë shërbim 148,007 individë dhe për vitin 2022 janë bërë 169,145 vizita, por mungojnë të dhëna të detajuara se sa prej tyre janë persona me aftësi të kufizuara.

Kujdesi shëndetësor parësor ofrohet nga njësia bazë e tij, pra Qendra Shëndetësore kryesore dhe nga ambulancat në nivel lagje. Shërbimi parësor është porta kryesore e trajtimit dhe monitorimit të qytetarëve. Mjeku i familjes në qendrat shëndetësore, kur e vlerëson të arsyeshme e referon pacientin tek qendrat e specialiteteve ose në shërbimin spitalor, në varësi të situatës së pacientit. Pas trajtimit apo ndërhyrjes qendrat e specialiteteve apo shërbimi spitalor në rast nevojë e ridërgon/rikthen pacientin pranë shërbimit të mjekut të familjes, përfshirë këtu edhe rekomandimin për mjekun dhe recetën e rimbursueshme. Ndërkohë qendrat shëndetësore kanë përgjegjësi për ndërhyrjen e hershme të aftësisë së kufizuar dhe paraqitet e nevojshme bashkërendimi i punës për një ndërhyrje të vazhduar, holistike dhe të koordinuar me qëllim, parandalimin, lehtësimin dhe menaxhimin në kohë dhe me cilësi për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në të gjitha rastet në varësi të problematikës mjeku e referon fëmijën tek neuropediatri, qendra kombëtare për mirërritjen zhvillimin dhe rehabilitimin e fëmijës, specialist ORL, poliklinat e specialiteteve pediatrike dhe kur ka probleme zhvillimi, konjitive apo/dhe sociale e referon tek punonjësi i mbrojtjes fëmijëve etj.


Intervista me Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijës, si dhe fokus grupet e zhvilluara nxorën në pah nevojën e intensifikimit të ndërveprimit mes shërbimit mjekësor parësor dhe punonjësve të mbrojtjes së fëmijës dhe administratorët shoqëror në çdo njësi administrative kufizuara me qëllim identifikimin dhe ndërhyrjen e hershme, vlerësimin dhe adresimin në kohë, por edhe sigurimin e një shërbimi ndërdisiplinar dhe gjithëpërfshirës. Sipas të dhënave të raportuara nga Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës gjatë 2022 janë menaxhuar 161 raste të fëmijëve në nevojë për mbrojtje nga të cilët vetëm një prej tyre ka qene me aftësi të kufizuar dhe vazhdon të jetë edhe për vitin 2023.

3.3 Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim

Grafiku nr. 7: Nr I fëmijëve PAK sipas Lagjeve-Njësive Administrative

Janë 393 fëmijë me aftësi të kufizuara në këtë Bashki. Referuar numrit të përgjithshëm të fëmijëve në këtë Bashki (40,165 fëmijë) rezulton se 0,98% e tyre kanë të paktën një formë të aftësisë së kufizuar.

Ndërsa, njësia administrative me numrin më të madh të fëmijëve me aftësi të kufizuara është Njësia e Paskuqanit me 153 fëmijë, vijuar nga Lagjia Bathore me 102 fëmijë, Kamëz me 81 fëmijë, Lagjia nr 1 Valias 32 dhe Lagjia nr 2 Frutikulture me 25 fëmijë.



Në Bashkinë Kamëz ndodhen 5 çerdhe të cilat në total kanë 520 fëmijë, 20 kopshte me 3166 fëmijë në total, 20 shkolla 9-vjeçare me 12.625 nxënës ku 0.7% e totalit është me aftësi të kufizuar dhe 5 gjimnaze të cilët kanë 3018 nxënës nga të cilët 1.1% e tyre rezulton të ketë një formë të aftësisë së kufizuar.

MASR është përgjegjëse për monitorimin dhe evidentimin e arritjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar.

Bashkia Kamëz pavarësisht të dhënave që posedojnë institucionet e arsimit, nuk ka të dhëna të plota apo detajuara periodike, të të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla, sipas moshës, gjinisë, diagnozës, nivelit të dëmtimit etj. Do ishte e dobishme nëse bashkia do të kishte të dhëna periodike dhe të plota të fëmijëve me aftësi të kufizuara në çerdhe, kopshte dhe shkolla, përfshirë edhe ato jopublike. Ndaj, paraqitet i rëndësishëm një koordinim i strukturuar, reciprok dhe periodik ndërmjet këtyre sektorëve. Këto të dhëna do të shërbenin për një gjurmim, adresim, mbulim e monitorim të koordinuar të çdo fëmije me aftësi të kufizuar. Informacioni që disponon sektori i mbrojtjes së fëmijës në bashki në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara në shkolla lidhet me rastet e fëmijëve në proces menaxhimi të rastit nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve.

Një problematikë e mprehtë që raportohet nga organizatat e fushës dhe ndikon negativisht në frekuentimin e shkollës shfaqen nevojat për mjete didaktike, gjë e cila mbetet sfidë dhe duhet të vlerësohen rast pas rasti nga komisionet e shkollave dhe përgatitja e tyre është pjesë e hartimit të PEI.

Në arsimin 9 vjeçar janë të rregjistruar 148 fëmijë me aftësi të kufizuar dhe në arsimin e mesëm 35 fëmijë të cilët përfitojnë edhe 200% të pagesës tyre.

Në të gjitha shkollat e Bashkisë Kamëz ka mësues ndihmës për fëmijët me AK. Janë 30 mësues ndihmës që mbështesin 183 fëmijë me aftësi të kufizuara, 16 prej të cilëve janë me arsim special.

Zyra Arsimore në bashkëpunim me ISHP përcaktojnë në varësi të testit, orët e nevojshme për mësuesit ndihmës, si dhe i rishikojnë ato në raport me avancimin e nxënësit. Sipas evidencave, kategoria mbizotëruese në shkolla është Autizmi dhe ka praktikisht nevojë për më shumë orë të mësuesve ndihmës.

Nga të dhënat në dispozicion është konstatuar se të gjithë shkollat janë të aksesueshme vecanërisht për personat me aftësi të kufizuara në lëvizje dhe ato të ndërtuara rishtazi janë të pajisura me rampa dhe ashensorë.

Gjithashtu edhe çerdhet edhe kopshtet janë të aksesueshme dhe të pajisura me rampa dhe kopshtet e ndërtuara rishtazi kanë edhe ashensorë. Një numër shumë i vogël i tyre e kanë hyrjen në të njëjtin nivel me tokën.

Ambientet dhe institucionet publike nuk janë kudo dhe tërësisht të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, kjo për arsyen se shumica prej tyre kanë qenë të ndërtuara më herët. Sipas të dhënave të raportuara nga Drejtoria e Projekteve dhe Investimeve, në zbatim të VKM Nr. 1074, është ndërhyrë në disa nga akset kryesore të territorit të Bashkisë Kamëz, përfshirë këtu zonat më të populluara dhe ato me lëvizshmëri më të lartë. Në të gjitha trotuaret ku është ndërhyrë për mirëmbajtje, apo dhe në trotuaret e rrugëve të reja, janë aplikuar rampat për PAK, sipas standardeve teknike, me gjerësi jo më të vogël se 1m dhe pjerrësi jo më të madhe se 15%. Në ndërtimin e rrugëve të reja, apo kualifikimin e blloqeve të banimit janë zbatuar rampat sipas standardeve teknike. Në ndërhyrjet e mirëmbajtjes në trotuaret ekzistues është zbatuar standardi, atje ku ka lejuar gjendja faktike dhe janë bërë përshtatje atje ku gjendja faktike ka kushtëzuar zbatimin e standardeve, gjithmonë për të siguruar kalueshmërinë për PAK, apo për të minimizuar pengesën e qarkullimit të kësaj kategorie.

Ndër të tjera, prej vitit 2014, ka një detyrim ligjor për pajisjen me kamera të institucioneve publike, për sigurimin e cilësisë së shërbimit e si rrjedhojë të gjitha institucionet arsimore janë të pajisura me kamera dhe gjithashtu edhe akset kryesore rrugore.

3.4 Punësimi i PAK

Punësimi i personave me aftësi të kufizuara mbetet sfida. Përveçse numri i individëve në kërkim të një pune është i ulët, Zyra e Punës thekson se ndeshet me rezistencën e punëdhënësve, por edhe të punëkërkuesve me aftësi të kufizuara në përpjekjen për të nxitur punësimin e këtyre të fundit.

Administratorët shoqëror kanë informuar personat me aftësi të kufizuara mbi të drejtat që rrjedhin nga Ligji “Për aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara” në këndvështrimin e vijimit të pagesës së aftësisë së kufizuara edhe pas punësimit të tyre.



Ne bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Zyrës Punës, Administratorët shoqëror kanë referuar për punësim mbështetur nga Programi i Nxitjes së Punësimit të gjithë kategoritë e afta për punësim.

Janë 1063 persona që nuk kanë formë të rëndë të aftësisë së kufizuar, por vetëm 100 prej tyre janë të rregjistruar si punëkërkues në Zyrën e Punës (3.4% e punëkërkuesve në dhjetor 2022 janë persona me aftësi të kufizuara). Pra, vetëm 9.4% e personave me aftësi të kufizuar të një forme jo të rëndë është aktualisht në kërkim të një pune.

Gjithashtu, raportohet si eksperiencë pozitive punësimi i 9 personave me aftësi të kufizuara si pjesë e administratës së Bashkisë Kamëz.

Siç u theksua edhe në analizën e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, janë pothuajse 130 familje që kanë të paktën një pjesëtar me aftësi të kufizuara që përfitojnë ndihmën ekonomike nga sistemi i NE ose Fondet e Bashkisë.

Bashkia Kamëz, përveç ndihmës ekonomike nga fondet e bashkisë ofron nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimi Social tre programe nëpërmjet të cilëve janë përfitues në total 327 individë, ndër këto 40 prej përfituesve janë me aftësi të kufizuara ose kanë në përbërjen familjare të tyre një person me aftësi të kufizuar. Grupi i personave me aftësi të kufizuar konsiderohet si grup prioritar për trajtimin me strehim në përputhje me ligjin për strehimin social.

3.5 Shërbimet zhvilluese dhe rehabilituese sociale

Në Bashkinë Kamëz shërbimet ekzistuese për personat me aftësitë kufizuara ofrohen nga institucione publike dhe jopublike. Shërbimet publike ofrojnë shërbim nëpërmjet Qendrës Komunitare Shumëfunksionale për fëmijë me aftësi të kufizuara dhe ka mungesë të ofrimit të shërbimeve për të rriturit me aftësi të kufizuara.

Qendra Komunitare Shumëfunksionale për fëmijë me aftësi të kufizuara ofron shërbim që prej tetorit të vitit 2022. Aktualisht në qendër marrim shërbim 55 fëmijë të cilët marrin shërbim terapeutik individual dhe në grup. Shërbimi në qendër ofrohet 2 ose 3 herë në javë, në varësi të diganozës ose rastit gjykuar kjo nga ekipi multidisciplinar i qendrës. Një person me aftësi të kufizuara mund të përfitojë më shumë se një shërbim në qendër. 19 prej tyre marrin shërbim të kombinuar terapi zhvillimi, ndërhyrje në sjellje dhe komunikim si edhe rehabilitim fizik ose fizioterapi. Të gjithë fëmijët që marrin shërbim në qendër pasi dorëzojnë të gjitha dokumentacionin e nevojshëm i nënshtrohen një vlerësimi të plotë të nevojave nga ekipi multidisciplinar dhe ky i fundit përcakton planin terapeutik individual unik ku përfshin objektivat afatmesëm e afatgjatë të shërbimeve për fëmijën me aftësi të kufizuar. Krahas shërbimit ditor individual në qendër ofrohet shërbim terapeutik në grup i cili bazohet në një plan të përcaktuar dhe vihet në zbatim një herë në javë me grupmosha dhe diagnoza të ngjashme. Temat e trajtuara në terapinë e grupit përcaktohen nga terapistët dhe ekipi multidisciplinar. Gjithashtu qendra ofron mbështetje dhe ngritje kapacitetesh, informim dhe fuqizim për të gjithë prindërit ose familjarë të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Me konkretisht shërbimet që ofrohen në qendër janë:

- Terapi e të folurit, logopedi (veshtirësi në komunikim);
- Këshillim psikologjik;
- Terapi zhvillimi (rastet që paraqesin vështirësi në arsimimin special);
- Terapi okupacionale (me fokus të mësuarit e një zanati në nivel bazik);
- Shërbime rehabilituese, edukative për mbajtjen dhe rritjen e aftësive fizike dhe sociale (autonomia dhe higjena personale);
- Aktivitete të socializimit rikreative-kulturore;
- Rehabilitim fizik (fizioterapi).

Puna me prindërit dhe familjet është një pjesë e pandarë nga ofrimi i shërbimit në qendër. Ky shërbim ofrohet në një vijë të drejtë paralele me shërbimin individual. Krahas mbështetjes emocionale qendra ofron takime individuale ose në grup për ngritje kapacitetesh, informim dhe fuqizim për të gjithë prindërit ose familjarë të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, qendra ofron trajnimin e familjarëve për të nxitur kontributin e tyre si një faktor shumë i rëndësishëm në zhvillimin e fëmijës. Këto takime lidhen kryesisht me identifikimin e rasteve, ku duhet ti drejtojmë dhe si ti menaxhojmë ato. Gjithashtu, qendra herë pas here ofron sesione terapie në grup për prindërit në mënyrë që të ndajmë eksperiencat me njëri-tjetrin si edhe të mësojmë nga të ngjashmit (peer support).

Përveç Qendrës Komunitare e cila është në varësi të Bashkisë Kamëz, egziston edhe një qendër tjetër në territorin e Bashkisë e njohur si Global Care e cilat ofron shërbim për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe është e vendosur në lagjen Bathore.

Dukshëm shërbimet që ofrohen janë shumë të kufizuara dhe nuk mbulojnë nevojat e të gjithë grupit të aftësisë së kufizuar, si nevojat e fëmijëve ashtu edhe të të rriturve. Mungesa e shërbimeve për persona me aftësi të kufizuara raportohet si një sfidë në menaxhimin e rasteve nga administratorët shoqëror të PAK-ut. Për ata që jetojnë në zonat rurale të Bashkisë distanca nga shërbimi dhe kur ekziston, si dhe mungesa e transportit e bën të pamundur marrjen e shërbimit. Veçanërisht u theksua nga këto njësi pamundësia e menaxhimit të rasteve të personave me probleme të shëndetit mendor. Tek ky grup vihet re një tendencë në rritje edhe e braktisjes nga familjarët e tyre, problem që ende nuk adresohet si nga mungesa e shërbimeve sociale ashtu dhe ndërveprimi i pamjaftueshëm mes menaxherëve të rastit dhe punonjësve shëndetësorë. Shërbimi për personat që nuk dëgjojnë është gjithashtu i munguar. Nga ana tjetër në kushtet kur adresimi i të gjitha nevojave është i vështirë e deri diku i pamundur, ndiqen dy qasje kryesore: (a) prioritizimi i nevojave për shërbime dhe (b) referimi në organizata që ofrojnë shërbime në territor.

Bashkia Kamëz, në bashkëpunim me Insitutin VISUM, në kuadër të projektit “Rritja e aksesueshmërisë në informacion të personave me aftësi të kufizuara në shikim” hartoi një broshurë me shkrimin BRILLE e cila përmban informacion të detajuar rreth shërbiemeve që merren në bashki duke siguruar kështu aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara në shikim në informacionin online dhe shërbimeve vendore të bashkisë Kamzës përmes mbështetjes së aksionit komunitar dhe zgjidhjeve teknike.

Disa nga ndërhyrjet prioritare të parashikuara për vitet e ardhshme:

- Qender komunitare, shërbime ditore për personat me aftësi të kufizuara për grupmoshat mbi 18 vjeç.
- Shërbime të levizëshme për zonat ku ka mungesë të ofrimit shërbimeve.
- Programe për nxitjen e punësimit në bashkëpunim me AKPA në kuadrin e fondit të punësimit.
- Njohja e viteve të punës për kujdestarin që kujdeset për fëmijë PAK duke hequr dorë nga puna (në mënyrë analoge me ligjin e tetraplegjikëve).
- Shërbime për jetesë të pavarur për të rinj me aftësi të kufizuara. Zgjerim i modelit të ngritur tashmë në lagjen Valias të zgjerohet edhe në njësinë Paskuqan.
- Kurse e praktika pune për të rinjtë me nevoja të posaçme;
- Mbeshtetja psiko-sociale e prinderve me femije me nevoja të vecanta;
- Formalizim i rrjetit të aktorëve publikë dhe privatë të domosdoshëm për menaxhimin e rasteve të qytetarëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre. Në mënyrë të veçantë përfshirje e strukturave të shëndetësisë.
- Ngritja e Njësisë së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave me qëllim identifikimin e hershëm të kategorisë me aftësi të kufizuara.
- Ngritja e shërbimeve të interpretimit në gjuhën shqipe dhe strukturave të përgjegjëse të bashkisë për ofrimin e shërbimeve.
- Mundësimi i aksesit në informacion për personat me aftësi të kufizuara që ofron bashkia.
- Organizimi i fushatave ndërgjegjësues për personat që nuk dëgjojnë për shërbime informuar në gjuhën e shenjave shqipe.
- Menaxhim i rasteve sociale për njerëz me aftësi të kufizuara interpretimi në gjuhën e shenjave.

4. FËMIJË NË NEVOJË PËR MBROJTJE DHE PËRKUJDESJE


Madhësia e grupit dhe shtrirja në territor

Për të analizuar nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror të fëmijëve në territorin e Bashkisë Kamëz u mbledhën të dhëna të vitit 2022 mbi raste të menaxhuara të fëmijëve të identifikuar në rrezik nga sektori i mbrojtjes së fëmijëve. Të dhënat u raportuan nga Sektori i Mbrojtjes së Fëmijës dhe Barazisë Gjinore.

Problemet social-ekonomike renditen kryesoret në rastet që menaxhohen nga Sektori i Mbrojtjes së Fëmijës dhe Barazisë Gjinore në Bashkinë Kamëz.

Sektori i Mbrojtjes së Fëmijës dhe Barazisë Gjinore referon një rritje të aftësisë së identifikimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për shërbime nga punonjësit e mbrojtjes së fëmijës në Bashkinë Kamëz.

Sipas të dhënave të raportuara në Bashkinë Kamëz gjatë vitit 2022 janë menaxhuar nga Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve 161 raste të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje.



Grafiku nr. 8: Rastet e menaxhuara të fëmijëve, viti 2022

Karakteristikat e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje

71 raste të fëmijëve të menaxhuar gjatë vitit 2022 lidheshin me problemet social ekonomike të familjeve të tyre (45% e totalit të rasteve);

7 fëmijë u identifikuan në situatë rruge (4% e rasteve);

Kanë përjetuar të paktën një formë të dhunës 35 fëmijë (22% e rasteve të menaxhuara), nga të cilët: 18 fëmijë përjetuan dhunë fizike, 5 fëmijë dhunë seksuale dhe 12 fëmijë dhunë psikologjike.

Në 7 raste fëmija u identifikua i/e neglizhuar nga prindi/prindërit.

Janë menaxhuar gjatë vitit të analizuar 14 raste fëmijë në konflikt me ligjin (9% e rasteve) dhe vetëm 1 rast të fëmijëve me aftësi të kufizuara (1% e rasteve).

U identifikuan si viktimat/viktima të mundshme trafikimi 3 fëmijë (2% të rasteve). Janë menaxhuar gjatë vitit të analizuar 11 raste të fëmijëve pa kujdes prindëror (8% e rasteve). 8 fëmijë u identifikuan me sjellje vetëdëmtuese/tentativë vetëvrasje (5% e rasteve).

Nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës nënvizohet që ka 4 raste të menaxhuara të fëmijëve që janë riatdhesuar (1% e rasteve).

Fëmijë shtetas të huaj të pashoqëruar janë një tjetër grup, për të cilin Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës thekson se në vitet e fundit nuk ka pasur raste të menaxhuara.

Nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës raportohen dhe raste të kategorive të tjera si braktisje shkolle (11 raste), caktim kujdestarie (4 raste), fëmijë në institucion rezidencial (6 raste) dhe problematika në ambientin shkollor (2 raste). Theksojmë që këto raste janë përfshirë në kategoritë e tjera referuar dhe problematikës fillestare të rastit apo arsyes së referimit.

Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës nënvizon gjithashtu se gjatë vitit 2022 janë marrë masa për 5 raste të mbikqyrjes të specializuar të fëmijës në mjedisin familjar, ndërsa masë emergjente për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosje në përkujdesjen alternative nuk është marrë përgjatë këtij viti.

Identifikimi dhe menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje apo përkujdesje

Bashkia Kamëz ka një mekanizëm të konsoliduar, si për identifikimin e rasteve të fëmijëve, ashtu edhe për menaxhimin e tyre. Rastet referohen kryesisht nga këta aktorë pjesë e mekanizmit lokal: Komisariati nr. 5; organizata joqeveritare; institucione arsimore; skuadra të terrenit (Bashkia Tiranë); Koordinatorja Vendore e Dhunës në Familje; njësitet e mbrojtjes së fëmijëve në bashki të tjera (raste të transferuara); me anë të identifikimit proaktiv në terren nga PMF.

Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale është përgjegjëse për çështjet e mbrojtjes së fëmijës në përgjithësi. Ajo, nëpërmjet strukturave në varësi të saj dhe në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të bashkisë, me mekanizmat vendorë të mbrojtjes dhe

institucionet e tjera vendore, merr të gjitha masat e nevojshme për realizimin dhe garantimin e mbrojtjes së fëmijës në territorin e bashkisë.

Në tetor të vitit 2022 është ngritur Qendra Komunitare Shumëfunktionale për fëmijë me aftësi të kufizuara në bashkëpunim me UNDP dhe Bashkinë Kamëz. Ngritja e kësaj qendre u përgjigjet nevojave të vlerësuara nga përvoja praktike, të adresuara për ngritjen e shërbimeve të reja dhe inovative të pushtetit vendor, duke synuar ofrimin e shërbimeve të integruara shëndetësore për fëmijët me nevoja të veçanta me qëllim mirëqënien e cilësisë së jetës së individit dhe familjes.

Përgjatë vitit 2022, janë 35 raste të fëmijëve që marrin shërbime të ndryshme nga Qendra Shumëfunktionale për fëmijët me AK si: *shërbim logopedik ose terapi e të folurit; shërbim psikologjik; këshillim; terapi zhvillimi; fizioterapi dhe rehabilitim fizik.*

Nga aktorët e mekanizmit lokal vihet re se ka *nivel tejet të ulët të referimit të rasteve nga punonjësit e shëndetësisë*, edhe pse ata janë në kontakt të drejtëpërdrejtë me fëmijët dhe familjet e tyre.

Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës kanë rol kyç në menaxhimin e rasteve të fëmijëve. Në përputhje me ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, në territorin e njërive/lagjeve administrative ka nga 2 PMF, ndërkohë që PMF përmbush edhe detyra që lidhen me menaxhimin e rasteve të dhunës në familje. Është e domosdoshme ngritja e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit.

Sfidë në menaxhimin e rasteve nga PMF është mungesa e buxhetit. Kostimi e më pas alokimi i buxhetit për menaxhimin e rastit në çdo njësi/lagje administrative mbetet i rendësishëm. Mungesa e tij krijon vështirësi për të adresuar me sukses nevojat e fëmijëve. Një tjetër sfidë është mungesa e qendrave komunitare që ofron shërbime direkte për fëmijët të cilët nuk janë me nevoja të veçanta dhe AK.

Në territorin e Bashkisë Kamëz ofrojnë shërbime për fëmijët Bashkia Kamëz dhe organizatat bashkëpunëtoare që operojnë brenda territorit dhe jo vetëm. Ka një rrjet të gjerë organizatash që ofrojnë shërbim për fëmijët ku mund të përmendim: World Vision, QDNjD, Global Care, Caritas, Olive for Charity, Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS, Të ndryshëm dhe të barabartë, Plan and Go.

Gjatë këtyre viteve, nisur nga nevojat e identifikuar, rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe familjet e tyre mbështeten nga fondet e bashkisë që shkon përtej paketave ushqimore dhe përfshin edhe aspekte të tjera si mbështetja me bonus qeraje apo ndihmë ekonomike. Në bashkëpunim me OJF partnere mbështetja është dhe më e madhe ku përfshihen;

- Asistim në komisariat;
- Shërbimet e emergjencës;
- Mbështetje/këshillim psikologjik;
- Mbështetje me medikamente;

- ☛ Mbështetje në transport;
- ☛ Mbështetje në çanta/mjete didaktike;
- ☛ Këshillim dhe mbështetje ligjore falas;
- ☛ Bonus qeraje;
- ☛ Paketa ushqimore higjeno-sanitare, veshmbathje, pako të ndryshme për fëmijët.

Kushtet e punës së PMF në njësi/lagje administrative janë të përshtatshme për të punuar me fëmijët, si dhe nuk ka mungesa në logjistikë (transport e mjete pune).

Në pamundësi të funksionimit të foster care në Bashkinë Kamëz, mundësia e vetme e sistemimit të fëmijëve të marrë në mbrojtje që prej miratimit të Ligj 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” është vendosja e fëmijëve në institucion të përkujdesjes rezidenciale.

Bazuar në udhëzim nr. 556, datë 29.7.2019 “Për mënyrën e vendosjes në institucionet e përkujdesit shoqëror për fëmijën ndaj të cilit është marrë masë mbrojtjeje” pas vlerësimit të plotë të rastit dhe hartimit të Planit Individual të Mbrojtjes, nga Grupi Teknik Ndërsektorial në rastet kur vlerësohet se fëmija do të vendoset në një institucion të përkujdestit shoqëror, i ndryshëm nga shërbimi i strehimit emergjent, vendosja në institucion bazohet, për aq sa është e mundur, në:

1. sistemimin e fëmijës në një institucion të përshtatshëm për moshën dhe nevojat e tij;
2. sistemimin e fëmijës në institucionin më të afërt me vendbanimin apo vendqëndrimin e tij kur ai është në vazhdim të procesit arsimor dhe/ose ndryshimi i institucionit arsimor do të ndikonte negativisht procesin e të nxënës;
3. sistemimin e fëmijës në institucionin publik ose jopublik rezidencial për fëmijë, më të afërt me vendbanimin apo vendqëndrimin e tij, kur ai është veçanërisht i shoqërizuar apo atashuar në aktivitete shoqërore apo me mjedisin familjar, largimi nga të cilët do të ndikonte negativisht në mirëqenien e tij;
4. sistemimin e fëmijës në institucionin më të afërt me shërbimet mjekësore që merr fëmija në rastet kur ai ka nevojë për kujdes të vazhduar mjekësor pranë një shërbimit të specializuar;
5. sistemimin e fëmijës me nevoja të veçanta në një institucion specifik të specializuar kur kjo vlerësohet si masa më e përshtatshme në interesin më të lartë të tij.

Për shkak të varësisë direkte të Institucioneve të Përkujdesit Rezidencial në Shërbimin Social Shtetëror dhe plotësimin e kapaciteteve të institucioneve, në praktikë jo gjithmonë ndodh që të realizohet sistemimi i fëmijës në institucionin publik ose jopublik rezidencial për fëmijë, më të afërt me vendbanimin apo vendqëndrimin e tij. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, me qëllim mbikëqyrjen, mbarëvajtjen dhe progresin e fëmijës për të cilën është marrë masë mbrojtjeje realizon kur është e mundur dhe/ose e nevojshme sipas

përcaktimeve në Planin Individual të Mbrojtjes: (a) takime me fëmijën e vendosur në institucion për të trajtuar dhe vlerësuar gjendjen psiko-sociale të tij; (b) takime me fëmijën e prindërve, familjarëve, të afërme apo shokëve e shoqeve, për të ruajtur marrëdhënie personale mes tyre, kur kjo nuk është e dëmshme për fëmijën; (c) përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për gjykatën në procesin gjyqësor të konfirmimit apo jo të masës së mbrojtjes dhe të vendosjes së fëmijës në kujdestari; (d) monitorimin e fëmijës pas daljes nga institucioni për një periudhë deri një vit, sipas standardeve të shërbimeve për fëmijë; dhe (e) vlerësimin e kushteve social - ekonomike të familjes, sipas kërkesave nga institucioni i përkujdesit shoqëror ku ndodhet fëmija, për planifikimin e rikthimit të fëmijës në familje.

Plani i deinstitutionalizimit

Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës punon për deinstitutionalizimin ⁵ e fëmijëve që marrin shërbim rezidencial. Procesi i deinstitutionalizimit bazohet në VKM Nr. 706 dt.09.09.2020 “Plani Kombëtar i Deinstitutionalizimit 2020-2022” dhe Planine Veprimit për zbatimin e tij, si edhe në Urdhërin Nr. 548 dt.01.10.2020 “Për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Drejtues për zbatimin e planit Kombëtar të deinstitutionalizimit 2020-2022”.

Në kuadër të këtij procesi, Bashkia Kamëz në bashkëpunim me Organizatën “Nisma Arsis”, kanë realizuar një sërë takimesh për hartimin e një plani të përbashkët ndër-institucional, si pararendës të përfshirjes së PMF-ve në hartimin e planeve individuale për çdo rast dhe ndjekjen e tyre me aktorët e përfshirë. Qëllimi është t’i jepet prioritet këtij procesi në sektorin e shërbimeve sociale duke rritur veçanërisht vëmendjen në fushën e mbrojtjes dhe kujdesit ndaj fëmijëve si dhe të përmirësohet infrastruktura e nevojshme ligjore e procedurale dhe ekspertiza teknike e ofruar nga ana e PMF në kontakt me çdo fëmijë dhe familje në proces deinstitutionalizimi.

Ngritja e një databaze të dhënash që siguron se çdo rast në trajtim koordinohet me ndërhyrjet e nevojshme, ka pasur një progres të dukshëm në zbatimin e planeve për fuqizimin e fëmijës dhe familjes. Nxitja e të gjithë aktorëve të përfshirë për të qënë pjesë kontribuese në përmirësimin e situatës së çdo familjeje të identifikuar ka qënë fokus i punës së NJMF pranë Bashkisë Kamëz. Planet individuale të zhvillimit për secilin fëmijë dhe plani i fuqizimit të familjes janë trajtuar në tryezat teknike me një qasje multidisiplinare duke bërë pjesëmarrës edhe vetë familjarët, duke u njohur atyre të drejtën legjitime për të ardhmen e fëmijës dhe përgjegjësinë prindërore.

Problematika të tjera

Aktualisht ka mungesa të shërbimeve për tipologji të caktuara në Bashkinë Kamëz. Specifikisht:

⁵Procesi i deinstitutionalizimit të sistemit të kujdesit për fëmijët bazohet në ndryshimin e tipologjisë së ofrimit të shërbimeve: nga institucione rezidenciale në shërbime ditore, si dhe shërbime të tjera alternative, me bazë.

Është në rritje numri i fëmijëve që përdorin lëndë narkotike apo alkool. Mungojnë shërbime të specializuara për rehabilitimin e tyre, sikurse ka vështirësi në rastet kur nuk kanë kujdesprindëror dhe duhet të marrin shërbim në spital, pasi është e nevojshme prezenca e një kujdestari që shoqëron fëmijën.

Mungon shërbim i specializuar afatgjatë për viktimat e abuzimit seksual. Qendra “Lilium” ofron shërbim vetëm për 72 orë, por mungon shërbimi i specializuar afatgjatë. Gjithashtu, është e nevojshme që të ndërtohet një metodologji se si GTN t’i qaset rasteve të abuzimit seksual.

Mungon shërbimi i specializuar për fëmijet në konflikt me ligjin. Ka një numër të lartë rastesh fëmijësh që shoqërohen në komisariate, fëmijë të dyshuar për vepra penale, abuzim apo që ushtrojnë dhunë në familje. Mungesa e informimit bën që fëmija të kthehet në komunitet dhe vijon të mbështetet me shërbimet bazë që ofrohen nga OJF të ndryshme, pa pasur mundësinë e një shërbimi të specializuar.

Rastet e fëmijëve me probleme të shëndetit mendor, sidomos kur janë viktimat të mundshme trafikimi, janë sfiduese pasi PMF shpesh ndeshen mungesën e qendrave komunitare që ofrojnë shërbime për këtë kategori.

Prioritetet e identifikuara për target grupin

- Takime informuese mbi rolin e PMF me struktura të shëndetësive në çdo njësi/lagje administrative, me qëllim nxitjen e tyre për referimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje;
- Buxhetimi i sektorit të mbrojtjes së fëmijës dhe barazisë gjinore për menaxhimin efektiv të rasteve të fëmijëve/familjeve;
- Fuqizimi i shërbimeve egzistuese të Bashkisë në kapacitetet dhe tipologji shërbimesh për të adresuar më mirë nevojat e fëmijëve, si dhe ngritja e qendrave ditore/emergjence që ofrojnë shërbime direkte për rastet në varësi të nevojave;
- Ngritje e shërbimeve të specializuara për fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe që kanë probleme të shëndetit mendor, fëmijë në konflikt me ligjin, viktimat të abuzimit seksual, si dhe fëmijë përdorues të drogës;
- Zgjerimi i shërbimit të ndërhyrjes së herëshme në çdo njësi/lagje administrative për parandalimin e rasteve;
- Shërbim në shtëpi për fëmijë me aftësi të kufizuara në zonat rurale dhe urbane që kanë të nevojshme terapi zhvillimi;

VIKTIMA TË DHUNËS NË FAMILJE


5.1: Sektori i dhunës në familje

Bashkia Kamëz, ka një strukturë të konsoliduar që u përgjigjet rasteve të dhunës ndaj grave e vajzave në territorin e bashkisë, që është Sektori i Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore, pjesë e Drejtorisë së Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale.

Numri i lartë i rasteve të dhunës, çoi në krijimin e sektorit të mbrojtjes së fëmijëve dhe barazisë gjinore për herë të parë në Bashkinë Kamëz, në shtator të vitit 2020. Me krijimin e sektorit u bë e mundur që secila Njësi/Lagje administrative të ketë punonjës të dedikuar për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Kjo nismë rriti padyshim efektivitetin në trajtimin dhe menaxhimin e rasteve.

Sektori i Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore menaxhon dhe ndihmon rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore duke siguruar mbrojtje, informim, strehim, këshillim psikologjik dhe ligjor, koordinim me të gjithë aktorët e rrjetit, në mënyrë që e mbijetuara të marrë një shërbim të plotë sipas rastit.

Ky sektor përbëhet nga 1 përgjegjës dhe 9 punonjës të mbrojtjes fëmijëve dhe barazisë gjinore dhe 1 koordinator vendor kundër dhunës në familje.



Në zbatim të Ligjit nr. 47/2018 "Për disa Shtesa dhe Ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare", të ndryshuar, neni 23, pika 3/1: "Gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UMM/UM-në, zyra e shërbimeve sociale

të njësisë së vetëqeverisjes vendore monitoron respektimin e urdhrit të mbrojtjes nga palët dhe çdo 60 ditë përgatit një raport, për të cilin, në çdo rast, vë në dijeni Policinë e Shtetit.

Në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje Sektori i Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore koordinon punën dhe bashkëpunon ngushtësisht me stafin social të Njësisë Administrative Paskuqan dhe 3 Lagjeve, konkretisht me administratorët shoqërorë dhe Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore në secilën njësi/lagje administrative. Bashkëpunimi me specialistët e njësisë/lagjeve administrative është shumë i ngushtë duke qenë se këta të fundit kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës (pagesat e ndihmës ekonomike etj), si dhe kryejnë vizitat në banesë sipas vendimit të gjykatës për zbatimin e UMM dhe/ose UM, duke dhënë edhe informacionin e nevojshëm.

Që prej muajit Dhjetor 2020, ka gjetur zbatim “Protokolli i Menaxhimit të Rasteve të dhunës në familje në nivel vendor përmes Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR)”⁶. Me Mekanizëm të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje nënkuptojmë mekanizmin e ngritur në nivel vendor në bazë të Ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar dhe VKM 334/2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij” (në proces rishikimi).

Ky Protokoll u përgatit për t’iu ardhur në ndihmë anëtarëve të këtij Mekanizmi (por edhe institucioneve të tjera përgjegjëse), për të standartizuar veprimet e nevojshme për një reagim të menjëhershëm, gjithëpërfshirës e me përgjegjshmëri për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës seksuale.

Bashkëpunimi dhe koordinimi mes aktorëve të ndryshëm të këtij mekanizmi në nivel teknik është tashmë i konsoliduar në Bashkinë Kamëz. Megjithatë është i nevojshëm zgjerimi i këtij mekanizmi me ofrues të rinj shërbimesh. Gjatë tre viteve të fundit MKR në Kamëz ka trajtuar 198 raste të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, ku rastet e dhunës kanë përfshirë edhe fëmijë. ETN dhe NJMF punon ngushtë me Njësitë/Lagjet Administrative, si dhe me organizatat e shoqërisë civile për të ndihmuar viktimat e dhunës në familje.

Edhe pse MKR e Bashkisë Kamëz viteve të fundit ka trajtuar 198 raste të dhunës në familje ose dhunës me bazë gjinore gjatë viteve, sfida mbetet identifikimi i rasteve të fshehta të dhunës në familje. Aktorë të ndryshëm pjesë e mekanizmit lokal janë të angazhuar në identifikimin e rasteve. Megjithatë, *strukturat shëndetësore, edhe pse janë bashkëpunuese, nuk identifikojnë raste pavarësisht se janë në kontakt të drejtpërdrejtë me komunitetin, nuk raportojnë kur shohin viktimat të dhunës edhe pse e kanë detyrim ligjor. Ky fakt ka nxitur ndërmarrjen e një numri takimesh nga koordinatorja vendore/punonjëset e barazisë gjinore të lagjeve/njësisë administrative pranë qendrave*


⁶ Përgatitur në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me mbështetjen e UNDP Shqipëri, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “T’i japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri” financuar nga Qeveria e Suedisë.

shëndetësore me qëllim informimin e tyre për detyrimin ligjor që kanë në raportimin e dhunës me bazë gjinore nëse e identifikojnë atë.

Në qershor 2021 u përditësua, VKM Nr. 327, datë 02.06.2021, për “Mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës” ⁷. Ndër të tjera, kjo VKM përcakton qartë rolin dhe detyrat e kordinatorit vendor për referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, Komitetit drejtues dhe të

gjithë anëtarëve të Ekipit Teknik Ndërdisciplinar të trajtimit të rasteve të dhunës në familje, përgatitjen e raporteve të vazhdueshme etj.

Grafiku nr. 9: Rastet e dhunës në familje ndër vite




Prej vitesh në Bashkinë Kamëz është punuar për ndërgjegjësimin kundër dhunës dhe pasojat e saj për familjen dhe komunitetin. 149 raste dhune u denoncuan në vitin 2021, në vitin 2022 janë denoncuar 106 raste të tilla dhe në vitin 2023 (tetor 2023) janë menaxhuar 75 raste.

Megjithatë ka një pranim të përgjithshëm të përfaqësuesve të institucioneve dhe organizatave të përfshira drejtpërdrejtë në përpjekjet për ta parandaluar dhe adresuar dhunën në familje se ka ende në territor raste dhune që nuk raportohen. Raportohen raste që edhe pas denoncimit të dhunës viktimat tërhiqet kryesisht për shkak të presionit të familjarëve apo fëmijëve për të mos dënuar dhunuesin.

Grafiku nr. 10: Rastet e dhunës në familje të pajisura me UMM

Të gjitha viktimat e dhunës në familje gjatë viteve 2020 dhe 2021, gjithsej 84 gra e burra kanë përfituar ndihmën ekonomike prej 3,000 lekë në muaj për sa kohë zgjat UM ose UMM. Ndërkohë në vitin 2022, janë menaxhuar 106 raste të cilët kanë përfituar UMM dhe nga këto 52 prej tyre kanë përfituar ndihmën ekonomike prej 99,00 lekë në muaj për aq kohë sa zgjat UM.



⁷ VKM no.327. 2021. Online <https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2021/07/VKM-Nr.-327-dat%C3%AB-2.06-00000002.pdf>

Raportohet vështirësi në menaxhimin e rasteve kur viktimat e dhunës ka probleme të shëndetit mendor, kur janë përdorues alkooli/droge, si dhe gra të komunitetit rom. Edhe kur shërbimet ekzistojnë shpesh dhënia e shërbimit refuzohet nga ofruesit e shërbimit, cka e bën më të vështirë pjesën e menaxhimit të rastit.

5.2 Shërbimet për viktimat e dhunës në familje

Bashkia Kamëz ka ofruar shërbime të ndryshme dhe ka arritur të zgjerojë paketën e shërbimeve në bashkëpunim me organizata joqeveritare dhe tashmë ka një praktikë të mirë në funksionimin e mekanizmit lokal për parandalimin e dhunës dhe adresimin e nevojave të viktimave të saj.

Përfshirja në këtë mekanizëm bashkë me institucionet lokale (polici, shëndetësi, arsim, gjykata, prokuroria) edhe e ofruesve të shërbimeve dhe organizatave ndër vite ka dhënë efektet e saj në tre këndvështrime:

1. *Ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve që punojnë për të adresuar dhunën në familje.* Trainime të vazhdueshme të mbështetura nga donatorët të ndryshëm dhe të zbatuara nga organizatat lokale kanë mundësuar njohjen dhe aplikimin e protokolleve të punës nga punonjësit e institucioneve (Bashki, shëndetësi, polici, etj). Megjithatë si stafi i Bashkisë edhe organizatat theksojnë se mbështetja në drejtim të rritjes së kapaciteteve duhet të vijojë. Nga një anë sepse legjislacioni specifik vijon të ketë ndryshime, përmirësime, nga ana tjetër sepse ka ndryshime në personelin që punon me dhe për viktimat e dhunës në familje në institucione të ndryshme.

2. *Ndërgjegjësimin e grave dhe komunitetit për efektet e dhunës në familje, si ta denoncojnë dhunën dhe shërbimet që ekzistojnë për të adresuar nevojat e viktimave të saj.* “Qendra të drejtat e njeriut në demokraci”, “Të ndryshëm, të barabartë”, “ARSIS”, “World Vision”, “Caritas”, “Global Care” dhe Young Women’s Christian Association of Albania - YWCA of Albania, përmes projekteve të ndryshme që kanë zbatuar dhe zbatojnë në territorin e Bashkisë kanë ndërmarrë në partneritet me institucionet lokale pjesë e mekanizmit të koordinuar lokal për dhunën në familje takime informuese dhe ndërgjegjësuere në komunitet dhe në shkolla.

3. *Ofrimin e shërbimeve rehabilituese dhe fuqizuese për viktimat e dhunës*

Pjesa dërmuese e rasteve të dhunës në familje drejtohen në Polici, por edhe kur ndodh ti drejtohen më parë mjekut të familjes rastet rregjistrohen dhe referohen në Polici edhe kur viktimat e dhunës nuk do ta denoncojnë rastin. Strukturat shëndetësore në Bashkinë Kamëz lëshojnë raporte të posaçme shëndetësore për rastet e dhunës. Punonjësit e policisë dhe mjekët njohin dhe zbatojnë protokollin e përcaktuar për raste të dhunës në familje.

Në trajtimin afatgjatë të rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, Sektori i Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore bashkëpunon ngushtësisht dhe me punonjësit social të Qendrës Shumëfunktionale Komunitare në varësi të Bashkisë Kamëz dhe OJF të ndryshme, ku referohen rastet, pasi të mbijetuarat kanë nevojë për mbështetje të

vazhdueshme për shkak të varfërisë, pagës së ulët, dhe faktit se duhet t'ia dalin të vetme pa asnjë mbështetje nga familja biologjike.

Organizatat joqeveritare të mbështetura nga donatorë, në Kamëz kanë luajtur një rol të rëndësishëm jo vetëm në ofrimin e shërbimeve për target grupe si gratë, fëmijët, PAK dhe familjet e tyre, por edhe në kontributin e dhënë për ofrimin e programeve të ndryshme për rritjen e edukimit dhe ndërgjegjësimin të fëmijëve dhe të rinjve mbi të drejtat e tyre dhe grupeve vulnerabel, apo mbështetjen dhe fuqizimin e kategorive të ndryshme si të rinjtë dhe gratë.

OJF-të konsiderohen si një strukturë e rëndësishme në ofrimin e shërbimeve, pasi mund të veprojnë edhe më shpejt sesa institucionet publike dhe kanë mundësi për të ofruar një cikël të plotë të shërbimeve. Përgjatë këtij viti u identifikuan disa forma shërbimesh që mundësojnë mbështetje në situata emergjente, si dhe programe me afatgjatë fuqizimi.

Disa nga shërbimet direkte të organizatave, pjesë e MKR, ofrohen nga:

- Linja e Këshillimit për gra dhe vajza;
- Linja e këshillimit për burra dhe djem;
- Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje;
- Qendra "Të drejtat e njeriut në demokraci".

"Caritas" ka një program i cili është në 3 vjecarin e dytë, pra përfundon në fund të 2025, është zyrë këshillimi karriere dhe punësimi me vendndodhje tek Pallati i kulturës çdo ditë ora 09:00-16:00. Ky projekt përfshin të rinjtë e moshës 15-30 vjec dhe ofron shërbime si: (a) Këshillim karriere-informacione për studime, (b) Trajnime soft skills, (c) Kurse profesionale duke paguar deri në 450 euro për të rinjtë në kategorinë vulnerabel ose ndërmjetësim me kurset që ofrohen pranë Qendrave të Formimit Profesional shtetëror, (d) Internship-praktikë e paguar për 3 muajt e parë, rroga dhe sigurime dhe ndërmjetësime me bizneset, (e) Gjatë 3 vjecarit të parë të zbatimit të projektit kanë përfituar 29 të rinj të mbështetur me internship dhe 26 prej tyre qëndruan në të njëjtën vend pune pas mbarimit të internshipit të paguar, (f) Start-up: Aplikim me ide biznesi, boot camp 4 ditor, plan biznesi, mbështetje deri në 5 mijë euro. Nga projekti i kaluar 9 biznese janë mbështetur dhe vetëm 2 kanë falimentuar.

"Caritas" gjithashtu prej dhjetë vjetësh punon me fëmijët dhe familjet në zonën e Babrru-së, pjesë e njësisë administrative Paskuqan. Programi i zhvilluar nga Caritas targeton drejtpërdrejtë fëmijët dhe të rinjtë, sikurse dhe familjet e tyre. Qendra ditore e ngritur funksionon nga ora 8.00-15.30, nga e hëna në të premte dhe ofron këto shërbime kryesore për rreth 70 fëmijë e të rinj: asistencë shkollë (rregjistrim në shkollë, rikthim në shkollë, përgatitja për në shkollë), aktivitete sociale, mbështetje për konsulta mjeksore, ndjekje e vaksinimit të fëmijëve, vakt ushqimor. Qendra ka ngritur programin e kurseve shkollë për të rinj, të cilët nuk kanë ndjekur ciklet shkollë dhe kanë mangësi të theksuara në shkrim e këndim. Qendra ka një sistem të vetin të ngritur për të identifikuar rastet e të rinjve dhe fëmijëve që kanë të nevojshme shërbimet e saj, pasi punon me komunitetin dhe ka një njohje të mirë të realitetit të familjeve. Qendra ndërvepron edhe me Bashkinë për identifikimin e rasteve.

“Nisma ARSIS” aktualisht është duke zbatuar projektin “Të rinj të fuqizuar, agjentë të ndryshimit dhe pjesëmarrës aktiv të nismave komunitare me natyrë sociale në Bashkinë Kamëz” me mbështetjen e UNDP në kuadër të programit ReLOaD2. Grupet e synuara janë të rinjtë dhe të rejat e grupmoshës 14-18 vjeç dhe 19-25 vjeç. Të rinjtë në Bashkinë Kamëz janë angazhuar dhe kanë marrë pjesë në procesin e vlerësimit të nevojave në komunitetin tyre dhe në hartimin e “Plani të Veprimit për Rininë për Bashkinë Kamëz 2024-2027”. Nisma ARSIS njëkohësisht është duke zbatuar programin “Aksesi në financa dhe mentorimi në biznes për sipërmarrësit e rinj” me mbështetjen e Sëiss Contact. Personat e përfshirë në program ndjekin një cikël mentorimi për një periudhë kohore 6 mujore për hapjen dhe rritjen e biznesit.

Në kuadër të programeve të zbatuara për mbrojtjen e fëmijëve veçanërisht atyre të vlerësuar në situatë rrisht të menjëhershëm, të lartë apo të mesëm ofrohet mbështetje në procesin e menaxhimit të rastit që nga pjesëmarrja në GTN dhe mbështetje për Punonjësit për Mbrojtjen e fëmijëve duke ofruar shërbime direkte (qera banese, paketa bazë ushqimore dhe higjienosantare, mbështetje administrative dhe ligjore, etj), asistencë teknike. Për rastet në rrezik të menjëhershëm ofrohet Shërbimi i Emergjencës së Sigurt deri në marrjen e vendimit në interesin më të lartë të fëmijës si dhe ofrohet shërbimi psikosocial për të miturit që janë në konflikt/kontakt me ligjin gjatë procesit të intervistimit në ambientet e Komisarariatit të Policisë nr.5. Nisma ARSIS është pjesë e ETN-ve të zhvilluara për rastet të cilat janë pajisur me Urdhër Mbrojtje, të organizuara nga Koordinatorin i Dhunës me bazë Gjimore në Bashkinë Kamëz në kuadër të funksionimit të MKR-së.

“World Vision” punon pranë komunitetit të Bashkisë Kamëz që nga viti 2008 duke mbështetur në mënyrë të drejtëpërdrejtë (fëmijë, të rinj,) si dhe në mënyrë indirekte të gjithë komunitetin lokal. Kjo organizatë zbaton një program i cili targeton grupmoshën 12-20 vjeç. Ngrihen përmes tij grupe impakti të fëmijëve që zhvillojnë takime të rregullta, dy ose tre herë në muaj gjatë një periudhë dy vjeçare. Pjesëtarët e grupit marrin njohuri mbi qytetarinë, lidhshirin, aksesin në punësim. Qëllimi është që ata të bëhen qytetar aktiv. Ata shërbejnë si katalizator të transformimit në komunitet. Në Kamëz janë 8 grupe të tilla me nga 15 pjesëmarrës. Fuqizimi i tyre shoqërohet me zbatimin më tej nga ata vetë të projekteve të tjera komunitare duke ndikuar kështu mbi pjesëtarët e tjerë të komunitetit. Këto grupe impakti kanë mundur tashmë mbështetje si vullnetarë për të moshuarit apo viktimat e dhunës në familje. Gjithashtu kjo organizatë është përfshirë drejtëpërdrejtë në menaxhimin e rasteve emergjente të individëve të identifikuar në nevojë për përkujdesje.

“Global Care” ku me mbështetjen e donatorëve ka ngritur një qendër komunitare në Bathore duke ofruar shërbime që targetojnë fëmijët dhe familjet në këtë territor. Pjesë e shërbimit janë: (a) Grupet e shkollës, ndihmojnë fëmijë me vështirësi në të nxënë dhe me aftësi të kufizuara të grupmoshës 7-14 vjeç. Janë dy grupe me 40 fëmijë gjithsej që mbështeten për përgatitjen për në shkollë, ndërsa fëmijët me aftësi të kufizuara përfitojnë edukim special. (b) Terapi për fëmijë me aftësi të kufizuara, përfshin fizioterapi, logopedi, terapi zhvillimi, terapi grupi. Janë 20 fëmijë që përfitojnë këtë shërbim një pjesë merr terapinë dhe rikthehet në shtëpi, një pjesë janë pjesë e kopshtit, (c) Grupet rinore, që kanë qëllim edukimin, zhvillimin për grupmoshën 15-18 vjeç. 20 të rinj takohen tre herë në javë, një ditë në javë është grupi sportiv, zhvillojnë aktivitete në qendër ose në komunitet. Kjo qendër mbështet gjithashtu edhe komunitetin rom/egjiptian në Zallmner, shërbimet janë sporadike, pra nuk punohet çdo ditë me ta. Gjatë vitit Qendra mundëson 2-3 kampe verore me fëmijët dhe takime të nënave në Zallmner.

Prej pesë vitesh “Olive for Charity” punon në territorin e Bashkisë duke mobilizuar donacione nga burime të ndryshme me ushqime apo veshje dhe duke mbështetur familje në

vështirësi ekonomike. Përgjithësisht rastet i drejtohen organizatës vetë ose identifikohen nga vetë organizata. Megjithatë kur rastet referohen nga Bashkia Kamëz stafi i qendrës kryen një vlerësim në familje për rastin e referuar dhe vijon me mbështetjen kur vlerësonse ajo është e nevojshme. Qendra ka arritur të mbështesë fëmijë jetim me bursa mujore apo pension familjar, sikurse ka ofruar kurse të gjuhës angleze dhe turke falas për të rinjtë.

Shoqata Kristiane e Grave Shqiptare (YWCA of Albania) u krijua për të kontribuar në fuqizimin e grave dhe të vajzave shqiptare përmes mbrojtjes së të drejtave të tyre e të fëmijëve, përmes formimit dhe informimit mbi çështje me interes të drejtëpërdrejtë për to, përmes punësimit dhe shërbimeve të posaçme në ndihmë të tyre.

Shoqata synon të mobilizojë forcën e grave dhe të vajzave, që t'i angazhojë ato në çështjeme rëndësi jetike për gjithë shoqërinë për të siguruar të drejta njerëzore, liri, drejtësi, dinjitet, siguri, shëndet e paqe.

Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale në bashkëpunim me aktorë të ndryshëm dhe OJF, ka ofruar shërbime të vazhdueshme për rastet e menaxhuara, ndër të cilat mund të përmëndim:

- Ndihmë Ekonomike;
- Raste të veçanta nga fondet e bashkisë;
- Bonuse për subvencionim të qirasë ose interesave të kredisë;
- Këshillim psikologjik dhe ligjor;
- Punësim;
- Mbështetja me pako ushqimore dhe higjeno-sanitare;
- Pajisje Elektroshtëpiake;
- Përfshirja në kurse profesionale;

Në paketat e shërbimeve Bashkia Kamëz ka përfshirë në programet e strehimit me prioritet viktimat e dhunës në familje. Në periudhën janar-gusht 2021 nevoja për strehim është identifikuar për 20 viktima të dhunës në familje (13.4% e rasteve të dhunës kanë kërkuar mbështetje për strehim). Në po të njëjtën periudhë kanë përfituar nga shërbimi i strehimit të Bashkisë Kamëz 12 viktima dhune në familje pra 60% e tyre janë trajtuar me një nga programet e strehimit.. Ndërkohë në vitin 2022 vetëm 5 viktima të dhunës në familje kanë përfituar strehim social. Një ndër arsyt kryesore që nuk i ka lejuar viktimat e dhunës në familje që të mund të përfitojnë nga kjo skemë është mungesa e kontratës së qerasë, një dokument i rëndësishëm për aplikim, kjo si pasojë e informalitetit.

Në çdo rast strehimi për viktimat e dhunës në familje mundësohet nga Bashkia, por nga momenti i aplikimit deri në përfitimin e këtij shërbimi kalojnë tre muaj dhe në këtë hark kohor viktimat mbështetjet nga ofrues jopublik, aktiviteti i të cilëve varet nga financimi i donatorëve.

5.3 Këshillimi ligjor dhe shërbimi psikosocial

Të gjithë rastet e menaxhuara nga kordinatori vendor i dhunës, kanë perfituar shërbim ligjor pa pagesë dhe rreth 70% e viktimave të dhunës në familje kanë përfituar shërbim psikosocial. Për gjithë territorin e Bashkisë Kamëz këto dy forma të shërbimeve janë ofruar përmes Linjës së Këshillimit. Ndërkohë shërbimi ligjor prej vitesh është ofruar nga Qendra e të Drejtave të Njeriut në Demokraci e cila ka ofruar konsulenca ligjore dhe përfaqësime në gjykatë për rastet e dhunës në familje.

Bashkia Kamëz ka patur në fokus kategorinë e viktimave të dhunës, ku përvec pagesës në sistemin e ndihmës ekonomike për UM, i ka trajtuar këto kategori vazhdimisht me pagesë nga të ardhurat e bashkisë si dhe ka luajtur një rol të rëndësishëm në bashkëpunim me zyrën e punës lidhur me mbështetjen e viktimave të dhunës me programet e nxitjes së punësimit me qëllim lehtësimin e situatës ekonomike sociale të tyre.

Ndër të tjera Bashkia ka mundësuar shërbime mbështetëse edhe për fëmijët e viktimave të dhunës pranë Qendres Komunitare Multifunkionale Valias, duke i ofruar krahas mbështetjes emocionale edhe takime individuale ose në grup për ngritje kapacitetesh, informim dhe fuqizim të tyre.

Çdo fillim viti shkollor, bashkia në bashkëpunim me OJF, ka mundësuar ofrimin e mjeteve didaktike (libra, canta, mjete shkollore) për 500 nxënës ku prioritet kanë patur fëmijët me probleme sociale. Për nënat e reja janë ofruar pako për bebe të porsalindura (150) me qëllim ardhjen në ndihmë dhe mbështetjen ekonomike të tyre.

Kordinatori vendor i dhunës në bashkëpunim me sektorin e mbrojtjes fëmijëve dhe barazisë gjinore, me institucionet arsimore dhe organizatat jo qeveritare ka realizuar takime periodike me qëllim sensibilizimin dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore, më së tepërmi gjatë muajit Nëntor, në të cilin janë edhe 16 ditët e aktivizimit kundër dhunës ndaj gruas.

Sektori për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore në Drejtorinë e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale në Bashkinë Kamëz, ndër kategoritë e tjera të fëmijëve në nevojë për mbrojtje ka në menaxhim edhe rastet e viktimave të trafikimit apo viktimave të mundshme të trafikimit. Aktualisht numërohen 2 raste me status VT/VMT me pagesë në sistem dhe familjet janë mbështetur gjithashtu edhe nga të ardhurat e bashkisë me rast të vecantë si dhe pako ushqimore.

Shërbimet kryesore që janë ofruar për rastet: këshillim psiko-social, asistencë për plotësimin e nevojave bazike (ushqim-veshëmbathje), asistencë mjekësore, asistencë ligjore, ofrim kursesh social-edukuese, përfshirjen në aktivitete që nxisin dhe zhvillojnë aftësitë sociale, mbështetje me materiale didaktike për vazhdimin e shkollës, ofrimi i shërbimit logopedik/terapisë së zhvillimit, mbështetje për punësimin e prindërve të tyre etj.

Përvec menaxhimit të rasteve një fokus të veçantë marrin edhe aktivitetet sensibilizuese për ndërgjegjësimin ndaj trafikimit të qenieve njerezore, përgjatë gjithë vitit, por me një



intensitet akoma më të madh gjatë muajit Tetor. Sektori i Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore në bashkëpunim me Zyrën Arsimore Kamëz, organizatat që veprojnë në zonë, përfaqësues të komisarariatit nr.5, kanë zhvilluar një sërë aktiviteteve nëpër shkolla të ndryshme të Bashkisë Kamëz dhe në komunitet.

Që prej muajit Maj 2023 e në vazhdim, Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale, ka realizuar aktivitete periodike mujore me familjet me vështirësi ekonomike dhe sociale, në bashkëpunim me YWCA of Albania në kuadër të projektit “Bashkitë mbështesin parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore përmes masave të integruara të mbrojtjes sociale”.

Prioritet për vitet në vijim lidhur me këtë target grup mbetet:

Krijimi i njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit ku të ketë të paktën edhe një punonjës social që të punojë për identifikimin, menaxhimin dhe referimin e viktimave të dhunës në familje tek shërbimet.

Ngritja e shërbimit të emergjencës për viktimat e dhunës në familje në gjithë territorin e bashkisë.

Zgjerimi i shërbimeve fuqizuese për viktimat e dhunës në familje.

Publikimi i broshurave dhe materialeve promovuese kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore dhe të shpërndahen rregullisht në të gjitha qendrat e njësive administrative dhe në qendrat shëndetësore.

Krijimi i një sistemi aplikimi për ndihmë ekonomike dhe shërbime të tjera për viktimat e trafikimit dhe viktimat e abuzimit seksual, në mënyrë që të garantojë mbrojtjen e të dhënave personale dhe shmangien e stigmatizimit.

Thjeshtimi i procedurave dhe rritja e mbështetjes për programet e strehimit për viktimat e dhunës në familje.

6. ROMET DHE EGJIPTIANËT

Bashkia Kamëz ka bërë përpjekjet e saj për të përmirësuar kushtet e jetesës së pakicave romë dhe egjiptiane, dhe integrimin e tyre në komunitet. Megjithatë ka progres, dhe situata e pakicave romë dhe egjiptiane është përmirësuar gjatë viteve të fundit, mbetet sfida e mëtejshme varfëria, diskriminimi, integrimi në tregun e punës, qasja në shërbimet shëndetësore dhe përmirësimi i kushteve të strehimit. Gjithashtu konstatohet dhe vazhdon të jetë problematik hendeku i krijuar midis romëve dhe egjiptianëve në raport me joromët në të gjitha fushat jetësore dhe në përfitimin e shërbimeve apo të mirave publike.

Në Bashkinë Kamëz u ngrit një grup pune me qëllim monitorimin e të gjithë zonës, për një periudhë tre-mujore, në bashkëpunim me ndërlidhësat në komunitet, keshilltarët, administratorët e lagjeve/njesisë dhe administratoret shoqëror të ndihmës ekonomike për rregjistrimin e familjeve romë dhe egjiptiane në të gjithë teritorin e bashkisë. Nga ky studim u evidentuan 329 familje dhe u krijua një database me të gjithë të dhënat e nevojshme për identifikimin dhe informimin e tyre rreth të gjithë shërbimeve sociale që ofron bashkia përfshirë edhe aplikimin në systemin kombëtar të ndihmës ekonomike.

Megjithatë, romët dhe egjiptianët kanë më pak gjasa për të plotësuar kriteret për përfitimin nga shërbimet sociale (duke përfshirë ndihmën ekonomike) për shkak të mungesës së dokumenteve personale ose të transferimit formal të vendbanimit, analfabetizmit ose paaftësisë për të plotësuar formularët e aplikimit, procedurave tepër të komplikuara, pasja e pronësisë ligjore mbi toka që ata nuk i zotërojnë etj. Si rezultat momentalisht janë 52 familje të përfshië në sistemin e NE, Fondin 6% dhe rasteve të veçanta nga fondet e bashkisë.

Ndër të tjera është mundësuar identifikimi i rasteve të paregjistruar në regjistrin e gjendjes civile si pasojë e lindjeve jashtë sistemit shëndetësor, lindjeve nga prindër nën moshë, lindjeve në lëvizje, moskuptimit të rëndësisë dhe procedurave të regjistrimit civil apo dhe të vendbanimit, gjendjes së bashkëpunimit dhe koordinimit jo në nivelin e duhur mes strukturave që punojnë drejtëpërdrejt në komunitet etj.

Nga ana tjetër, varfëria dhe rëndësia e sigurimit të nevojave bazë ul ndjeshëm interesin e romëve dhe egjiptianëve për të përfunduar arsimin apo formimin profesional dhe programet e nxitjes së punësimit. Nga të dhënat e ZVA Kamëz, rezulton se ndjekin arsimin 9-vjeçar 364 fëmijë të komunitetit romë dhe egjiptian, nga këto 44.7% femra. Ndërsa në arsimin e mesëm të përgjithshëm ndjekin shkollën 21 fëmijë, nga të cilët 16 prej tyre janë femra.

Edhe pse janë orientuar drejtë zyrës së punës dhe anë referuar në programin e nxitjes së punësimit, ata gjejnë zgjidhje alternative që shpesh janë informale. Sektorët informalë, si p.sh. mbledhja individuale e mbetjeve të riciklueshme, tregtimi i mallrave të përdorura apo veprimtari të tjera që nuk kërkojnë trajnim të specializuar, gjenerojnë të ardhura më të larta krahasuar me pagën mujore minimale në sektorët formalë.

Gjithashtu kultura e varfërisë dhe përjashtimit, mungesa e besimit të programet ekzistuese të punësimit, përvojat negative në të kaluarën etj., bëjnë që pjesa më e madhe e romëve dhe egjiptianëve që punojnë në sektorin informal detyrohen të vazhdojnë të mbeten aty (duke pranuar pasiguritë e tregut informal të punës) dhe nuk parapëlqejnë të përfshihen në programet e nxitjes së punësimit.

Megjithatë, bashkia ka luajtur rol kyç në punësimin e tyre, veçanërisht në drejtorinë e pastrim-gjelbërimit, ujësjellësit por edhe në administratën e saj ku janë thuhetse 70 individë të punësuar, ka mundur shërbimin falas në çerdhe dhe kopshte me dreke për të gjithë familjet në pamundësi ekonomike. Gjithashtu puna me prindërit dhe familjet e këtij komuniteti është një pjesë e pandarë nga ofrimi i shërbimit në qendërën multifunksionale. Ky shërbim ofrohet në një vijë të drejtë paralele me shërbimin individual. Krahas mbështetjes emocionale qendra ofron takime individuale ose në grup për ngritje kapacitetesh, informim dhe fuqizim për të gjithë prindërit ose familjarë të fëmijëve romë dhe egjiptian me aftësi të kufizuara.

Ndër të tjera, ky target grup merr shërbim edhe nga organizata të ndryshme ku mund të përmendim "Caritas" ku marrin vakte ushqimi 54 fëmijë mesatarisht në ditë.

Prioritet i drejtorisë NE dhe Çështjeve Sociale mbetet krijimi i një Plani Veprimi ku do të analizohet në mënyrë të detajuar situatën e komunitetit rom dhe egjiptian dhe shërbimet ekzistuese dhe do të shërbejë si një mekanizëm orientues i veprimeve që aktorët vendorë duhet të ndërmarrin për të adresuar sfidat dhe barrierat që pengojnë dy komunitetet në sigurimin e një jete dinjitoze si dhe realizimi i aktiviteteve periodike me qëllim sensibilizimin dhe njohjen e rëndësisë së arsimit, punësimit, kujdesit shëndetësor, strehimit etj.

7. TE MOSHUARIT NË NEVOJË PËR SHËRBIME

Të moshuarit mbeten një grup i popullatës me nevoja me të larta për kujdes shëndetësor dhe social për arsye të mungesës së rrjeteve mbështetëse, varfërisë, lëvizshmërisë së reduktuar etj. Bashkia Kamëz ka rreth 22.000 pensionistë.

Drejtoria e Ne dhe Çështjeve Sociale, në bashkëpunim me administratorët e lagjeve dhe njësive, ka bërë të mundur evidentimin e 84 të moshuar të vetmuar të cilët kanë marr shërbim pranë Bashkisë në mënyrë të herë pas herëshme, por vlen të përmendet që numri i të moshuarve brënda territorit të bashkisë është më i lartë.

Nga ana e Bashkisë janë ndihmuar vazhdimisht të moshuar me probleme shëndetësore apo pa të ardhura të mjaftueshme. Rreth 20 persona të moshuar marrin mesatarisht çdo muaj ndihmë nga të ardhurat e bashkisë dhe shumë të tjerë mbështeten vazhdimisht me paketa ushqimore. 56 të moshuar marrin ndihmë nga sistemi i NE dhe 57 familje nga mosha e tretë janë ndihmuar nga programet e strehimit.

Brenda territorit të bashkisë Kamëz ndodhet edhe qendra polivalente ditore në të cilën marrin shërbim mesatarisht 29 të moshuar ne ditë (ushqim, kafe dhe argëtim).

Prioritet për vitet në vijim lidhur me këtë target grup mbetet:

Identifikimi në mënyrë të hollësishme i të moshuarve në nevojë për shërbim dhe referimin e tyre tek shërbimet.

Zgjerim i shërbimit në familje për të moshuarit që jetojnë vetëm, apo janë në vështirësi social-ekonomike.

Ndërtimin i një ambienti të përshtatshëm për të moshuarit.

Shërbim i lëvizshëm për të moshuarit me nevoja të veçanta.

Krijimi i rregjistrimit të vullnetarëve dhe aktivizimi i tyre në shërbim të të moshuarve në nevojë. Nxitja e vullnetarizmit në shërbim të kësaj kategorie.

8. PËRDORUESIT E DROGËS

Nuk ka të dhëna të rregjistruara nga institucionet publike mbi përdoruesit e drogës apo alkoolit. Nga intervista me strukturën shëndetësore rezultoi se edhe pse të dhëna nuk rregjistrohen, ka raste të përdoruesve të drogës apo alkoolit, por këto raste i referojnë menjëherë tek njësia e Toksikologjisë në QSUT.

Prioritet mbetet identifikimi i rasteve të përdoruesve të drogës në territorin e Bashkisë Kamëz dhe referimi i tyre në qendrat e shërbimit komunitar për rehabilitimin e përdoruesve të drogës.

9. ANALIZA SWOT

9.1 Pikat e forta

Vullneti i qartë për të përmirësuar dhe zhvilluar sistemin komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror

Ekipi drejtues, personeli i strukturës përgjegjëse aktuale për shërbimet sociale në këtë Bashki dhe në njësi/lagje administrative, sikurse dhe aktorë të ndryshëm lokalë të konsultuar përgjatë fazave të përgatitjes së Planit Social demonstrojnë vullnet, motivim dhe qartësi të plotë për nevojën për përmirësimin dhe zhvillimin e sistemit komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë Kamëz.

Bashkëpunimi ndërinstitutional dhe koordinimi me ofruesit e shërbimeve

Bashkia Kamëz ka shënuar progres në këndvështrimin e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe koordinimit me ofruesit e shërbimeve, edhe pse kjo praktikë duhet thelluar. Praktikën e ngritura të punës për mbrojtjen e fëmijëve dhe masat kundër dhunës në familje duhet të jenë udhërrëfyese për stafin social të Bashkisë për të ngritur sistemin e integruar të referimit të rastit dhe për të përfshirë në të çdo institucion publik, ofrues shërbimesh dhe organizata që janë të angazhuara në këtë fushë. Kjo Drejtori ka tashmë një njohje të thelluar të nevojave për shërbime të çdo grupi të identifikuar dhe duhet të koordinojë e drejtojë çdo përpjekje/projekt/iniciativë publike dhe jopublike që të jetë në një linjë me prioritetet dhe masat e parashikuara në Planin Social.

Ekzistenca e disa shërbimeve në territorin e Bashkisë dhe të Qarkut

Në territorin e Bashkisë ekzistojnë shërbime të kujdesit shoqëror jopublik që mbulojnë një pjesë të nevojave për shërbime. Partneriteti i stafit social të Bashkisë me ofruesit e këtyre shërbimeve është një pikë e fortë për zbatimin e komponentëve respektivë të parashikuar në këtë Plan. Në nivelin e Qarkut egziston çdo formë e shërbimit të kujdesit shoqëror të cilat mund të shërbejnë si modele për shërbimet që do të ngrihen si pjesë e Planit Social, sikurse një pjesë e nevojave për shërbime të emergjencës dhe shërbime të specializuara mund të mundësohen përmes shërbimeve në nivel qarku duke ulur kështu kostot për shërbime në këtë periudhë të zbatimit të Planit.

Kapacitete për të siguruar financime nga donatorë

Bashkia ka hapësira dhe mundësi zhvillimi dhe si rrjedhojë ka mundësi për të rritur vëmendjen ndaj grupeve vulnerable. Ka kapacitete për të thithur fonde, ka zgjeruar gradualisht burimet financiare dhe ka autonomi për të marrë vendime.

Burime njërëzore të kualifikuara

Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale ka rritur ndjeshëm numrin e punonjësve të kualifikuar, duke përmirësuar kështu procedurat e punës në të tre komponentët e organizimit të strukturave sociale në këtë Bashki.

9.2 Pika të dobëta

NjVNR

Bashkia Kamëz ka shënuar progres të prekshëm në menaxhimin e rasteve sociale, siç theksohet nga intervistat me institucione dhe ofrues shërbimesh në territor, gjë që është mundësuar nga shtimi i strukturës së kësaj drejtorie. Megjithatë ngritja e NjVRN shfaqet e nevojshme për të qenë efektive në identifikimin, menaxhimin dhe referimin e vazhdueshëm të rasteve sociale e për të garantuar mbrojtjen e përkujdesjen për çdo individ në situatë të pafavorëshme në këtë Bashki.

Harta e ofruesve të shërbimeve

Nuk ka të dhëna të pasura dhe të mjaftueshme nga ofruesit jopublikë të shërbimeve për të vlerësuar, planifikuar dhe ndërhyrë bazuar në tipologjinë e shërbimeve që ofron secila OJF.

Zgjerimi i paketës së shërbimeve

Shërbimet që janë ngritur me financim të Bashkisë dhe qeverisë qendrore janë të pamjaftueshme për të adresuar nevojat e grupeve të identifikuara. Një pjesë e mirë e shërbimeve ofrohen nga organizatat jofitimprurëse. Varësia e këtyre të fundit nga fondet e donatorëve i bën të paqëndrueshme shërbimet e për rrjedhojë rrit nevojën që Bashkia të alokojë më shumë fonde për të zgjeruar hartën e shërbimeve.

9.3 Mundësitë:

Kuadri ligjor i plotë

Ekziston tashmë një kuadër ligjor i plotë që rregullon ngritjen dhe funksionimin e sistemeve komunitare të kujdesit shoqëror. Legjislacioni kombëtar dhe strategjitë kombëtare janë udhërrëfyes të rëndësishëm për Bashkinë për të ngritur dhe zhvilluar praktika e marrë masa konkrete;

Partneriteti egzistues

Bashkia ka rritur partneritetin me institucione publike dhe me ofrues shërbimesh. Ndërkohë Bashkia ka kapacitete për të identifikuar donatorë të mundshëm, si dhe kërkuar financim prej tyre me qëllim ngritjen e fondit social dhe financimin e shërbimeve. Ekzistenca e këtij Planit Social lehtëson përpjekjet e Bashkisë në këtë drejtim. Hapësirat dhe mundësitë që ofron komuniteti i gjerë i biznesit në territorin e Bashkisë janë një mundësi për të zvogëluar hartën e vulnerabilitetit në territor.

Eksperienca dhe praktika të ngjashme

Shërbimet egzistuese në nivelin e Bashkisë dhe të Qarkut do të lehtësojnë punën e ekipit social për të modeluar dhe ngritur shërbimet e planifikuara në Planin Social. Bashkia ka tashmë ekipe dhe stafe të përgatitura dhe me përvojë si për identifikimin proaktiv të rasteve ashtu edhe për ofrimin e shërbimeve.

Zgjerimi i shërbimeve në të gjithë territorin e bashkisë.

Bashkia ka mundësi zhvillimi dhe financimi të shërbimeve si rrjedhje mundësi për të zgjeruar shërbimet ndaj grupeve në nevojë dhe ka kapacitet për të thithur fonde si nga Ministria e linjës, ashtu edhe nga donatorë vendas dhe të huaj përmes aplikimit me projekte mbi bazën e prioriteteve të përcaktuara në Planin Social Lokal

9.4 Rreziqe

Zgjerimi i hartës së shërbimeve kërkon investime që shpesh i kalojnë mundësitë e qeverisjes vendore.

Bashkia Kamëz, vitet e fundit ka patur rritje të familjeve që migrojnë nga zonat rurale të Shqipërisë e cila ka ndikuar në rritjen e nevojave për shërbim.

Ngritja e shërbimeve të reja, që nuk janë në praktikën aktuale të sistemit të shërbimeve të Bashkisë kërkon mbështetje të shtuar në zbatimin e standarteve të tyre.

Ofruesit jopublik të shërbimeve sociale zënë një vend të rëndësishëm në plotësimin e nevojave për shërbime, por ata varen nga donatorët. Kjo nënkupton që për të patur shërbime të qëndrueshme Bashkia duhet të arrijë të forcojë dhe zhvillojë më tej fondin social të nevojshëm.


10. Prioritetet

- Krijimi i njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit ku të ketë të paktën edhe një punonjës social që të punojë për identifikimin, menaxhimin dhe referimin e viktimave të dhunës në familje tek shërbimet.
- Ndërgjegjësim dhe informim i vazhdueshëm i pjesëtarëve të familjeve përfituese të NE mbi faktin që përfitimi i ndihmës ekonomike është masë e përkohëshme dhe punësimi është rruga e vetme për të mundësuar fuqizimin ekonomik të familjeve.
- Ndërveprim i vazhdueshëm mes çdo Administratori shoqëror dhe Referimi me Zyrën e Punës së Agjensisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive si dhe DRSSHSH për të nxitur referimin për punësim të individëve në moshë pune të familjeve përfituese të NE.
- Zgjerimi i rrjetit të ofruesve të shërbimeve dhe organizatave
- Zgjerimi i shërbimeve për komunitetin rom dhe egjiptian dhe për të moshuarit e vetmuar.
- Qender komunitare, shërbime ditore për personat me aftësi të kufizuara për grupmoshat mbi 18 vjeç.
- Shërbime të lëvizëshme në zonat ku ka vështirësi për akses të shërbimeve për personat me nevoja të veçanta (fëmijët, të moshuarit, grupmoshat mbi 18 vjeç)
- Programe për nxitjen e punësimit në bashkëpunim me AKPA në kuadrin e fondit të punësimit.
- Njohja e viteve të punës për kujdestarët që kujdesen për fëmijë PAK duke hequr dorë nga puna (në mënyrë analoge me ligjin e tetraplegjikëve).
- Shërbime për jetesë të pavarur për të rinj me aftësi të kufizuara. Zgjerim i modelit të ngritur tashmë në lagjen Valias të zgjerohet edhe në njësinë Paskuqan.
- Kurse e praktika pune për të rinjtë me nevoja të posaçme;
- Mbeshtetja psiko-sociale e prindërve me fëmijë me nevoja të vecanta;
- Formalizim i rrjetit të aktorëve publikë dhe privatë të domosdoshëm për manaxhimin e rasteve të qytetarëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre. Në mënyrë të veçantë përfshirje e strukturave të shëndetësisë.
- Ngritja e shërbimeve të interpretimit në gjuhën e shenjave shqipe pranë strukturave përgjegjëse të bashkisë për ofrimin e shërbimeve për njerëzit që nuk dëgjojnë.
- Mundësimi i aksesit në informacion për njerëzit që nuk dëgjojnë lidhur me shërbimet që ofron bashkia.
- Organizimi i fushatave ndërgjegjëse dhe informuese lidhur me nevojat që kanë personat që nuk dëgjojnë për shërbimet e aksesueshme dhe të drejtën për tu informuar në gjuhën e shenjave shqipe.

- Menaxhim i rasteve sociale për njerëzit që nuk dëgjojnë duke siguruar shërbime interpretimi në gjuhën e shenjave.
- Takime informuese mbi rolin e PMF me struktura të shëndetësive në çdo njësi/lagje administrative, me qëllim nxitjen e tyre për referimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje;
- Buxheti i sektorit të mbrojtjes së fëmijës dhe barazisë gjinore për menaxhimin efektiv të rasteve të fëmijëve/familjeve;
- Fuqizimi i shërbimeve egzistuese të Bashkisë në kapacitetet dhe tipologji shërbimesh për të adresuar më mirë nevojat e fëmijëve, si dhe ngritja e qendrave ditore/emergjence që ofrojnë shërbime direkte për rastet në varësi të nevojave;
- Ngritje e shërbimeve të specializuara për fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe që kanë probleme të shëndetit mendor, fëmijë në konflikt me ligjin, viktimat të abuzimit seksual, si dhe fëmijë përdorues të drogës;
- Zgjerimi i shërbimit të ndërhyrjes së hershme në çdo njësi/lagje administrative për parandalimin e rasteve;
- Ngritja e shërbimit të emergjencës për viktimat e dhunës në familje në gjithë territorin e bashkisë.
- Publikimi i broshurave dhe materialeve promovuese kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore dhe të shpërndahen rregullisht në të gjitha qendrat e njësive administrative dhe në qendrat shëndetësore.
- Thjeshtimi i procedurave dhe rritja e mbështetjes për programet e strehimit për viktimat e dhunës në familje.
- Krijimi i një Plani Veprimi ku do të analizohet në mënyrë të detajuar situatën e komunitetit rom dhe egjiptian
- Identifikimi në mënyrë të hollësishme i të moshuarve në nevojë për shërbim dhe referimin e tyre tek shërbimet.
- Fuqizimi dhe zgjerimi i shërbimeve ekzistuese të bashkisë në kapacitete dhe tipologji shërbimesh për të moshuarit;
- Krijimi i regjistrit të vullnetarëve dhe aktivizimi i tyre në shërbim të të moshurve në nevojë. Nxitja e vullnetarizmit në shërbim të kësaj kategorie.
- Identifikimi i rasteve të përdoruesve të drogës në territorin e bashkisë Kamëz dhe referimi i tyre në qendrat e shërbimit komunitar për rehabilitimin e përdoruesve të drogës.

11. QËLLIMET, OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET

Për të mundësuar përmbushjen e Vizionit dhe Misionit në Planin e Veprimit të Bashkisë Kamëz për periudhën 2024-2026 janë parashikuar ndërhyrje në pesë drejtime kryesore:



1. *Fuqizimi i strukturave dhe kapaciteteve të shërbimeve sociale.* Masat e parashikuara përfshijnë: (a) Ngritja e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe e Referimit të Rasteve (NjVNR); (b) Ngritja e strukturave të supervizimit të shërbimit të mbrojtjes së fëmijëve në bashki; (c) Fuqizimi i strukturave të shërbimit social dhe të strehimit në bashki; (d) Fuqizimi i bashkëpunimit me strukturat e shëndetësisë;
2. *Zhvillimi i sistemit të integruar dhe të organizuar të shërbimeve të kujdesit shoqëror për të mundësuar mirëqënien, pavarësinë dhe përfshirjen shoqërore të individëve dhe familjeve në nevojë.* Masat e parashikuara përfshijnë: (a) Ofrimi i shërbimeve sipas vlerësimit të nevojave të familjeve/individëve; (b) Ngritja e strukturave të ofrimit të shërbimit në komunitet; (c) Zgjerimin e kapacitetit të bashkisë për ofrimin e shërbimeve emergjente/direkte për familjet/personat në nevojë/fëmijët/viktimat e dhunës; (d) Përmirësimi i infrastrukturës në institucione/investime publike/hapësira publike për kategoritë në nevojë.
3. *Zgjerimi i hartës sociale në Bashkinë Kamëz.* Masat e parashikuara përfshijnë: (a) Zhvillimi i partneriteteve me OJF; (b) Zgjerimi me shërbime të reja të ofruara në bashkinë Kamëz në bashkëpunim me OJF; (c) Zgjerimi me përfshirjen aktive të komunitetit në shërbime sociale; nxitja e vullnetarizmit në ofrimin e shërbimeve.
4. *Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë.* Masat e parashikuara përfshijnë: (a) Mbështetja dhe fuqizimi i familjeve në nevojë; (b) Mbështetja dhe fuqizimi i grave kryefamiljare (veçanërisht nënat me shumë fëmijë të grupmoshave nën 18 vjeç); (c) Mbështetja dhe fuqizimi i komunitetit Rom dhe Egjiptian.
5. *Zhvillimi i komponentit parandalues të shërbimeve të kujdesit shoqëror.* Masat e parashikuara përfshijnë: (a) Të rritet niveli i ndërgjegjësimit në komunitet; (b) Përfshirja e komunitetit në vendimmarrjet që lidhen me sistemin komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror.



OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: FUQIZIMI I STRUKTURAVE DHE KAPACITETEVE TË SHËRBIMEVE SOCIALE						
AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	BURIMI I TË DHËNAVE	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO
Objektivi specifik 1.1: Ngritja e Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe e Referimit të Rasteve (NjVNR).						
Aktiviteti 1.1.1: Krijimi i strukturës së NjVNR në bashki sipas numrit të popullsisë dhe nevojave të shërbimit (sipas ligjit 1 punonjës social për 10.000 banorë).	Bashkia Kamëz Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale	2024-2026	a) një punonjës social të vlerësimit dhe referimit të rastit për çdo 6 000 deri në 10 000 banorë; b) një punonjës për mbrojtjen e fëmijëve për çdo 3 000 fëmijë; c) administrator shoqëror.	Legjislacioni përkatës në fuqi; Ligji i shërbimeve të kujdesit shoqëror; Bashkia Kamëz.	Bashkia Kamëz	
Aktiviteti 1.1.2: Diskutimi dhe miratimi i përkrahjeve të punës të figurave profesionale që do përbëjnë NjVNR.	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale	2024	Përkrahimet e punës për të gjithë profesionistët.	Legjislacioni përkatës në fuqi; Ligji i shërbimeve të kujdesit shoqëror.	Bashkia Kamëz	

Aktiviteti 1.1.3: Trajnim mbi funksionimin e NjVNR.	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale OJF	2024-2025	Moduli i trajnimit; Numri i stafit që ka nevojë për trajnim.	Legjislacioni përkatës në fuqi; Ligji i shërbimeve të kujdesit shoqëror; Protokolli për funksionimin e NjVNR; Ligji për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve; Dokumente të praktikave të mira.	
Objektivi specifik 2.1: Ngritja e strukturave të supervizimit të shërbimit të mbrojtjes së fëmijëve në bashki.					
Aktiviteti 2.1.1: Vlerësimi i nevojave dhe planifikimi i supervizimit në strukturat e mbrojtjes së fëmijëve.	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale	2024	Dokumenti i planifikimit të supervizimit; Marrëveshja vjetore e supervizimit për çdo PMF.	Legjislacioni përkatës në fuqi; Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"; Udhëzimet sipas ASHMDF.	
Aktiviteti 2.1.2: Zbatimi i procedurave të supervizimit dhe roleve e përgjegjëse të supervizuesit e të supervizuarit (sipas udhëzimeve të ASHMDF).	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale	2024	Numri i takimeve të supervizimit të realizuara në raport me numrin e takimeve të planifikuara në marrëveshjen vjetore.	Legjislacioni përkatës në fuqi; Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"; Udhëzimet sipas ASHMDF.	

Objektivi specifik 3.1: Fuqizimi i strukturave të shërbimit social dhe të strehimit në bashki.						
Aktiviteti 3.1.1: Zhvillimi i rrjetit të ofruesve të shërbimeve me punësimin e psikologut pranë Bashkisë Kamëz.	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror OJF	2024-2026	1 psikolog i rekrutuar.	Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".	Bashkia Kamëz	
Aktiviteti 3.1.2: Thjeshtimi i procedurave dhe rritja e mbështetjes për programet e strehimit për familjet në nevojë/ viktimat e dhunës/ viktimat e trafikimit/ nënat kryefamiljare/ personat PAK etj.	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale Drejtoria e Strehimit dhe Emergjencave Civile OJF	2024-2026	Numri dhe tipologjia e rasteve që aplikojnë për programet e strehimit.	Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"; Ligji "Për strehimin social".	Bashkia Kamëz	
Objektivi specifik 4.1: Fuqizimi i bashkëpunimit me strukturat e shëndetësisë.						
Aktiviteti 4.1.1: Takime informuese mbi rolin e punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve me strukturat e shëndetësisë në çdo njësi/lagje administrative me qëllim nxitjen e tyre për referimin e rasteve të	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Qendrat	2024-2026	Numri i rasteve të referuara pranë strukturave përkatëse në raport me numrin e personave të kategorive në nevojë që marrin shërbim pranë qendrave shëndetësore.	Legjislacioni përkatës në fuqi.		

fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje.	shëndetësore në territorin e Bashkisë Kamëz	2024-2026	Identifikimi i qendrave shëndetësore në territorin e Bashkisë Kamëz dhe bashkëpunim i vazhdueshëm për aktivitete ndërgjegjëse dhe publikimin e broshurave me informacionet përkatëse për kategoritë në nevojë.	Legjislacioni përkatës në fuqi; Ligji "Për masat kundër dhunës në familjare".	Bashkia Kamëz	
Aktiviteti 4.1.2: Publikimi i broshurave dhe materialeve promovuese kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore dhe shpërndarja në mënyrë periodike në të gjitha qendrat shëndetësore në territorin e Bashkisë Kamëz.	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Qendrat shëndetësore në territorin e Bashkisë Kamëz; OJF					

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: ZHVILLIMI I SISTEMEVE TË INTEGRUAR DHE TË ORGANIZUAR TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR PËR TË MUNDËSUAR MIRËQËNIEN, PAVARËSINË DHE PËRFSHIRJEN SHOQËRORE TË INDIVIDËVE DHE FAMILJEVE NË NEVOJË

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	BURIMI I TË DHËNAVE	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO
Objektivi specifik 2.1: Ofrimi i shërbimeve sipas vlerësimit të nevojave të familjeve/individëve.						
Aktiviteti 2.1.1: Ngritja e Qendrës Multifunksionale Paskuqan; shërbime për fëmijë me aftësi të kufizuara dhe në nevojë për mbrojtje, shërbime psikosociale, programe të kurseve shkollore për të rinjtë, shërbime të emergjencës.	Bashkia Kamëz Drejtoria e Ndihmës. Ekonomike dhe Çështjeve Sociale Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	2024-2026	Infrastruktura e godinës e përshatshme për ofrimin e shërbimeve komunitare; Shërbimet përbërëse të ngritura dhe funksionale në përputhje me standartet kombëtare për shërbimin specifik; Stafet profesionale të trajnuara për ofrimin e shërbimeve sipas tipologjise.	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror"; Bashkia Kamëz; VKM 518, datë 04.09.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror, komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit sipas target grupeve dhe gjinisë".	Bashkia Kamëz	

Aktiviteti 2.1.2: Ngritja e qendrës multifunksionale për personat me aftësi të kufizuar për grupmoshat mbi 18 vjeç: shërbim ditor ose terapi individuale sipas nevojës; këshillim, orientim për prindërit e personave me AK; shërbim i lëvizshëm.	Drejitoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	2024-2026	Infrastruktura e godinës e përshtatshme për ofrimin e shërbimeve komunitare; Shërbimet përbërëse të ngritura dhe funksionale në përputhje me standardet kombëtare për shërbimin specifik; Stafet profesionale të trajnuara për ofrimin e shërbimeve sipas tipologjise.	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror"; Bashkia Kamëz; VKM 518, datë 04.09.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror, komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitim të tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit sipas target grupeve dhe gjinisë"; Ligji "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara".	Bashkia Kamëz
--	--	------------------	---	---	----------------------

Aktiviteti 2.1.3: Kalimi në administrimin e Bashkisë Kamëz të Qendrës polivalente ditore për të moshuarit.	Bashkia Kamëz Shërbimi Social Shtetëror Drejtorja e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale	2024-2026	Procedura administrative e kalimit të varësisë; numri i përfutësëve në raport me numrin e individëve/familjeve në nevojë për këtë shërbim; kategoritë e shërbimeve dhe programeve të ngritura në raport me ligjin; burimet në dispozicion.	Legjislacioni përkatës në fuqi.	Bashkia Kamëz
Objektivi specifik 2.2: Ngritja e strukturave të ofrimit të shërbimit në komunitet.					
Aktiviteti 2.2.1: Ngritja e skuadrave të lëvizshme, në bashkëpunim me partnerët dhe skuadrat e shërbimeve për ofrimin e shërbimeve lëvizëse për kategoritë në nevojë.	Drejtorja e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale NjVRN OJF	2024-2026	Numri i skuadrave të ngritura në raport me numrin e rasteve në nevojë për shërbime lëvizëse.	Legjislacioni përkatës në fuqi; Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"; Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".	Bashkia Kamëz

Aktiviteti 2.2.2: Ofrimi i shërbimeve të kujdesit në shtëpi për të moshuarit e vetmuar.	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale OJF	2024-2026	Dokumenti i modelit pilot për të moshuar; kostimi i ngritjes të ofrimit të shërbimit; numri i përfituesëve në raport me numrin e individëve/familjeve në nevojë për këtë shërbim; Kategoritë e shërbimeve dhe programeve të ngritura në raport me ligjin.	Legjislacioni përkatës në fuqi.	Bashkia Kamëz
Objektivi specifik 2.3: Zgjerimin e kapacitetit të bashkisë për ofrimin e shërbimeve emergjente/direkte për familjet/personat në nevojë/fëmijët/viktimat e dhunës.					
Aktiviteti 2.3.1: Ngritja dhe funksionimi i qendrës së emergjencës/pritëse për rastet e për fëmijët në nevojë për mbrojtje/personat në nevojë dhe viktimat e dhunës në familje dhe	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale OJF Ministria Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	2024-2026	Dokumenti i modelit të shërbimit; Kostimi i ngritjes dhe ofrimit të shërbimit.	Legjislacioni përkatës në fuqi; Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"; Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror	Bashkia Kamëz

ofrimi i shërbimit 24 orësh.				në Republikën e Shqipërisë"		
Aktiviteti 2.3.2: Trajnim mbi funksionimin e shërbimit të strehëzës së emergjencës/pritëse për fëmijët në nevojë për mbrojtje/personat në nevojë dhe viktimat e dhunës në familje.	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale OJF	2024-2026	Moduli i trajnimit; Numri i stafit të trajnuar në raport me numrin e stafit që ka nevojë për trajnim.	Legjislacioni përkatës në fuqi; Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" Dokumentat e praktikave të mira; Dokumenti i modelit të shërbimit.		
Aktiviteti 2.3.2: Shërbim i strehimit të mbrojtur për viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit.	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale Koordinatori vendor për masat kundër dhunës në familje.	2024-2026	Apartamente/hapësira funksionale për çdo rast; staf i dedikuar dhe i trajnuar për shërbim; numri i rasteve që kërkojnë akomodim në kushtet e emergjencës	Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"; Ligji "Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare"; VKM 518, datë 04.09.2018 "Për	Bashkia Kamëz	

				shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitim të tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar"; Vendim nr. 505, datë 13.07.2011 "Për miratimin e standarteve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje".	
--	--	--	--	---	--

Aktiviteti 2.3.3: Shërbim rehabilitimi për personat me varësi nga droga/alkooli në nivel komunitar.	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale	2024-2026	Numri i rasteve të raportuara pranë qendrave shëndetësore dhe/ose që kanë përfutur nga programe rehabilitimi.	Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"; VKM 518, datë 04.09.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfutimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfutuesit e shërbimit të organizuar".	Bashkia Kamëz
Objektiv specifik 2.4: Përmirësimi i infrastrukturës në institucione/investime publike/hapësira publike për kategoritë në nevojë.					
Aktiviteti 2.4.1: Përmirësimi i infrastrukturës dhe hapësirave publike për të garantuar akses në shërbime/përfshirje sociale dhe në komunitet	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale Drejtoria e investimeve Ndërmarrja e	2024-2026	Numri i mjediseve/hapësirave të përshtatura për personat me nevoja të veçanta në raport me numrin e hapësirave që kanë nevojë për	Legjislatiioni përkatës në fuqi.	Bashkia Kamëz

për kategorinë PAK dhe të verbërit.	shërbimeve publike		ndërhyrje për tu përshtatur për personat me nevoja të veçanta.		
Aktiviteti 2.4.2: Ngritja e shërbimeve të interpretimit në gjuhën e shenjave shqipe pranë strukturave përgjegjëse të bashkisë për ofrimin e shërbimeve për personat që nuk shikojnë/dëgjojnë.	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale Ndërmarrja e shërbimeve publike Qendra Shumëfunktionale për fëmijët me AK	2024-2026	Identifikimi i mjediseve/hapësirave që kanë nevojë për ndërhyrje për tu përshtatur për personat me nevoja të veçanta që nuk shohin/dëgjojnë.	Legjislacioni përkatës në fuqi.	Bashkia Kamëz
Aktiviteti 2.4.3: Përmirësimi i infrastrukturës së bashkisë për të krijuar mjedise miqësore (veçanërisht konfidenciale për fëmijët).	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale OJF	2024-2026	Numri i mjediseve/hapësirave të kthyer në mjedise miqësore për fëmijët në raport me numrin e mjediseve/hapësirave që kanë nevojë për këtë përmirësim; Takimet me fëmijët duhet të ruajnë konfidencialitetin.	Legjislacioni përkatës në fuqi; Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve".	Bashkia Kamëz

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: ZGJERIMI I HARTËS SOCIALE NË BASHKINË KAMËZ

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	BURIMI I TË DHËNAVE	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO
Objektivi specifik 3.1: Zhvillimi i partneriteteve me OJF						
Aktiviteti 3.1.1: Zgjerimi i rrjetit të ofruesëve të shërbimeve dhe organizatave.	Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Tiranë Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale OJF	2024-2026	Numri i ofruesëve të shërbimeve në qarkun Tiranë dhe OJF që janë të angazhuara me projekte për grupe specifike në nevojë të identifikuara dhe të kontaktuara; Nisma dhe veprime të përbashkëta të ndërmarra bazuar në prioritetet e planit social; Ndikimi i vlerësuar mbi komunitetin në nevojë për shërbime.	Legjislacioni përkatës në fuqi; Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror"; Vendim nr. 135, datë 07.03.20218 "Për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror.		

Aktiviteti 3.1.2: Partneriteti me organizata të shoqërisë civile që punojnë në fushën e fuqizimit ekonomik të grupeve të dizavantazuara.	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale	2024-2026	Numri i organizatave me të cilat bashkia ka ndërtuar partneritet për qëllime të fuqizimit ekonomik të individëve në nevojë; Numri i bizneseve sociale të ngritura në territorin e bashkisë; Numri i individëve të detajuar sipas gjinisë, pjesë e grupeve në nevojë, të punësuar në biznese sociale; Numri i nënave kryefamiljare, pjestarëve të komunitetit rom/egjiptian, personave me aftësi të kufizuara, viktimave të dhunës dhe trafikimit që kanë arritur të punësohen çdo vit.	Ligji "Për asistencën sociale"; Ligji "Për ndërmarrjet sociale".	
Objektivi specifik 3.2: Zgjerimi me shërbime të reja të ofruara në bashkinë Kamëz në bashkëpunim me OJF.					

Aktiviteti 3.2.1: Ofrimi i programeve të prindërimit pozitiv dhe të shëndetshëm, menaxhimi i zemërimit për dhunuesin, fuqizimi i viktimave të dhunës në familje, trafikimit etj.	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale OJF	2024-2026	Numri i përfituesëve në raport me numrin e individëve/familjeve në nevojë për këtë shërbim; kategoritë e shërbimeve dhe programeve të ngritura në raport me ligjin; Numri i stafit për përfitues në raport me ligjin; Burimet e alokuara në raport me numrin e individëve/familjeve në nevojë për këtë shërbim.	Bashkia Kamëz	
Aktiviteti 3.3.1: Krijimi i regjistrat të vullnetarëve dhe aktivizimi i tyre në shërbim të të moshuarve në nevojë.	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale OJF	2024-2026	Numri i përfituesëve në raport me numrin e të moshuarve në nevojë për këtë shërbim; kategoritë e shërbimeve dhe programeve të ngritura në raport me ligjin; Numri i stafit për regjistrim në raport me ligjin; Burimet e alokuara në raport me numrin e individëve/familjeve në nevojë për këtë shërbim.		
Objektivi specifik 3.3: Zgjerimi me përfshirjen aktive të komunitetit në shërbime sociale; nxitja e vullnetarizmit në ofrimin e shërbimeve.					

OBJEKTIVI STRATEGJIK 4: ZBUTJA DHE LEHTËSIMI I VARFËRISË

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	BURIMI I TË DHËNAVE	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO
Objekti specifik 4.1: Mbështetja dhe fuqizimi i familjeve në nevojë.						
Aktiviteti 4.1.1: Ndërgjegjësim dhe informim i vazhdueshëm i pjesëtarëve të familjeve përfituese të NE mbi faktin që përfitimi i ndihmës ekonomike është masë e përkohshme dhe punësimi është rruga e vetme për të mundësuar fuqizimin ekonomik të familjeve.	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale Zyra e Punës Kamëz OJF	2024-2026	Praktika të mira dhe raste suksesi të fuqizimit ekonomik të familjeve në nevojë në Bashkinë Kamëz.			
Objekti specifik 4.2: Mbështetja dhe fuqizimi i grave kryefamiljare (veçanërisht nënat me shumë fëmijë të grupmohave nën 18 vjeç).						
Aktiviteti 4.2.1: Identifikimi i grave/nënave kryefamiljare (veçanërisht nënat me shumë fëmijë të grupmohave nën 18 vjeç) në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz.	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale Drejtoria e Strehimit dhe Emergjencave Civile Zyra e Punës	2024-2026	Numri i grave/nënave kryefamiljare të identifikuar nga sistemi i ndihmës ekonomike, nga zyrat e punës, institucionet arsimore dhe ofrues të tjerë të shërbimeve në Bashkinë Kamëz.	Legjislacioni përkatës në fuqi; Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror".		

	Kamëz OJF		
Aktiviteti 4.2.2: Zhvillimi i partneriteteve me Zyren e Punës dhe ofrues jopublikë shërbimesh për mbështetjen me kurse për formim profesional/mundësi punësimi për gratë/nënat kryefamiljare (veçanërisht nënat me shumë fëmijë të grupmohave nën 18 vjeç).	Drejtorja e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale Zyra e Punës Kamëz OJF	2024-2026	Numri i grave/nënave kryefamiljare në vështirësi ekonomike dhe të papuna të identifikuar nga sistemi i ndihmës ekonomike, nga zyrat e punës, institucionet arsimore dhe ofrues të tjerë të shërbimeve në Bashkinë Kamëz.
Aktiviteti 4.2.3: Përfshirja e grave/nënave kryefamiljare (veçanërisht nënat me shumë fëmijë të grupmohave nën 18 vjeç) në fondet e veçanta të bashkisë dhe në programet e OJF-ve si faktor ndihmës për fuqizim ekonomik.	Drejtorja e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale Zyra e Punës Kamëz OJF	2024-2026	Identifikimi i grave/nënave kryefamiljare (veçanërisht nënat me shumë fëmijë të grupmohave nën 18 vjeç) në vështirësi ekonomike.
			Legjislacioni përkatës në fuqi; Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror".
			Legjislacioni përkatës në fuqi; Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror".

Aktiviteti 4.2.4: Njohja e viteve të punës për gratë/nënat që kujdesen për fëmijët/personat PAK duke hequr dorë nga puna.	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	2024-2026	Identifikimi i grave/nënave të papuna që kujdesen për fëmijë/persona PAK.	Legjislacioni përkatës në fuqi; Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror".	
Objektivi specifik 4.3: Mbështetja dhe fuqizimi i komunitetit Rom dhe Egjiptian.					
Aktiviteti 4.3.1: Hartimi i një plani veprimi lokal për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrjen aktive të komunitetit rom/egjiptianë.	Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Tiranë Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale OJF	2024-2026	Numri i familjeve të identifikuar të komunitetit rom/egjiptianë; Numri i ofruesëve të shërbimeve në qarkun Tiranë dhe OJF që janë të angazhuara me projekte për grupe specifike në nevojë të identifikuar dhe të kontaktuara; nisma dhe veprime të përbashkëta të ndërmarra bazuar në prioritetet e planit social; Ndikimi i vlerësuar mbi komunitetin rom/egjiptianë në nevojë për shërbime.	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror"; Plan kombëtar i veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë.	Bashkia Kamëz

Aktiviteti 4.3.2: Sesione informuese dhe ndërgjegjësuere me anëtarë të komunitetit Rom/Egjiptianë për rëndësinë e arsimit dhe përfitimet e komunitetit nga rritja e nivelit të arsimit tek brezat e ardhshëm.	Ministria e Arsimit dhe Sporteve Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale OJF	2024-2026	Numri i familjeve të identifikuar të komunitetit rom/egjiptianë; Nisma dhe veprime të përbashkëta të ndërmarra dhe të nevojshme për tu ndërmarrë për ndërgjegjësimin e komunitetit; Ndikimi i vlerësuar mbi komunitetin rom/egjiptianë në nevojë për shërbime.	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror"; Plani kombëtar i veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë.	
Aktiviteti 4.3.3: Zhvillimi i bashkëpunimit për punësimin për kategoritë në nevojë të komunitetit rom/egjiptianë, veçanërisht për të rinjtë e këtij komuniteti.	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale Zyra e Punës OJF	2024-2026	Numri i personave të punësuar në raport me numrin e personave në nevojë për punësim.	Legjislacioni përkatës në fuqi; Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror"; Strategjia Kombëtare për komunitetin Rom/Egjiptian	

OBJEKTIVI STRATEGJIK 5: ZHVILLIMI I KOMPONENTIT PARANDALUES TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	BURIMI I TË DHËNAVE	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO
Objektivi specifik 5.1: Të rritet niveli i ndërgjegjësimit në komunitet.						
Aktiviteti 5.1.1: Program i ndërgjegjësimit publik për internetin e sigurt dhe varësinë nga substancat me të rinjtë në shkolla.	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale OJF Ministria e Mbrojtjes Drejtoria Arsimore Rajonale	2024-2026	Plani i trajnimeve i hartuar; Numri i trajnimeve të zhvilluara në përputhje me fushat e identifikuara për ngritje kapacitetesh; Numri i pjesëmarrësve në trajnim në përputhje me rolet dhe funksionin që kanë.	Legjislacioni përkatës në fuqi.		
Aktiviteti 5.1.2: Programi i ndërgjegjësimit publik për mbrojtjen e fëmijëve.	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale OJF ASHDMF Mbrojtjes Drejtoria Arsimore Rajonale	2024-2026	Plani i trajnimeve i hartuar; Numri i trajnimeve të zhvilluara në përputhje me fushat e identifikuara për ngritje kapacitetesh; Numri i pjesëmarrësve në trajnim në përputhje me rolet dhe funksionin që kanë.	Legjislacioni përkatës në fuqi; Ligji "Për mbrojtjen e fëmijëve"		

Aktiviteti 5.1.3: Program ndërgjegjësimi për personat që kanë statusin e paraplegjikut dhe të verbërisë lidhur me të drejtën e tyre ligjore për akses falas në transportin publik.	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale Drejtoria e Transportit dhe Liçencave	2024-2026	Plani i trajnimeve i hartuar; Numri i trajnimeve të zhvilluara në përputhje me fushat e identifikuara për ngritje kapacitetesh; Numri i pjesëmarrësve në trajnim në përputhje me rolet dhe funksionin që kane.	Legjislacioni përkatës në fuqi; Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror".	
Objektivi specifik 5.2: Përfshirja e komunitetit në vendimmarrjet që lidhen me sistemin komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror.					
Aktivitet 5.2.2: Dëgjesa publike	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale Anëtarët e këshillit bashkiak Kategoritë në nevojë.	2024-2026	Organizimi i dëgjësave publike në mënyrë të vazhdueshme për të ftuar përfaqësues të biznesit dhe qytetarët për të marrë pjesë dhe për të shprehur problematikat, mendimet dhe sugjerimet e tyre mbi shërbimet ekzistuese apo atyre të reja të nevojshme.	Ligji "Për të drejtën e informimit publik" Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror".	

12. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Plani është parashikuar të zbatohet për një periudhë tre vjeçare dhe për çdo aktivitetet është përcaktuar koha e zbatimit duke vlerësuar si prioritetin e ndërhyrjes, ashtu edhe kapacitetet financiare për të zbatuar Planin Social në hapësirën kohore të parashikuar. Në plan është përcaktuar për çdo aktivitet njësia zbatuese e aktivitetit specifik. Zbatimi i planit është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Bashkisë, por partneriteti me organizata ofruese shërbimesh, institucione publike lokale e rajonale, si dhe grupe interesi është tejet i rëndësishëm për të mundësuar përmbushjen e objektivave të këtij Plani. Në Plan janë identifikuar partnerët kyç, por zbatimi i Planit dhe kushtet në ndryshim bëjnë të nevojshëm që Sektori Social ta zgjeroj vazhdimisht këtë rrjet partnerësh.

Plani do të jetë objekt rishikimi çdo vit veçanërisht në funksion të atyre aktiviteve për të cilat duhet të mbahen në konsideratë zhvillimet afatshkurtra lokale dhe nevojat koherente të individëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje. Përveç mbledhjes dhe analizës periodike të treguesve socialë Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale do të zhvillojë çdo vit dëgjesa me secilin prej grupeve vulnerabël e veçanërisht me: fëmijët, viktimat e dhunës në familje, përfaqësues të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit. Pas ngritjes së shërbimeve të kujdesit shoqëror të parashikuar në këtë Plan, kjo strukturë si pjesë e procesit të monitorimit të cilësisë së shërbimeve do të zhvilloj intervista/fokus grupe me përfitues të drejtpërdrejtë të këtyre shërbimeve.

Për efekt të monitorimit dhe vlerësimit për çdo aktivitet të Planit është përcaktuar lista e treguesve që lehtësojnë procesin e monitorimit dhe vlerësimit. Monitorimi i jashtëm do të lehtësoj gjithashtu proceset e monitorimit dhe të vlerësimit. Bazuar në detyrimet ligjore, disa prej aktiviteteve të përfshira në Plan Veprimi janë subjekt i monitorimit, kontrollit apo inspektimit nga institucione kombëtare si: Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, Shërbimi Social Shtetëror, Inspektoriati Shëndetësor dhe i Mbrojtjes Sociale. Rezultatet e kontrolleve, monitorimeve apo inspektimeve do të mbahen gjithashtu në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit të Planit nga struktura përgjegjëse e shërbimeve të kujdesit shoqëror të Bashkisë.

13. PËRMBLEDHJE E BUXHETIT

Tabela 4 : Përmbledhje buxheti sipas qëllimeve dhe objektivave

QËLLIMET	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET DHE ZERAT E SHPENZIMEVE	KOSTO/NJESI	NJESI	PERIUDHA KOHORE	KOSTO VITI 1	KOSTO VITI 2	KOSTO VITI 3	TOTALI I VITEVE
QËLLIMI 1.	Objektivi 1.1	Aktiviteti 1.1							
	Objektivi 1.2	Aktiviteti 1.2							
QËLLIMI 2.	Objektivi 2.1.	Aktiviteti 2.1							
	Objektivi 2.2	Aktiviteti 2.2							
QËLLIMI 3.	Objektivi 3.1	Aktiviteti 3.1							
	Objektivi 3.2	Aktiviteti 3.2							

REFERENCAT

Ligje

- Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji Nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligji Nr.8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbrit";
- Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik";
- Ligji Nr.7889, datë 14.12.1994, "Statusi i invalidit ";
- Ligj Nr.18/2017 "Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës";
- Ligji Nr.8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e Jetimit";
- Ligji 22/2018 "Për strehimin social";
- Ligji 47/2018 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare";
- Ligji "Për barazinë gjinore".

Strategji Kombëtare

- Vendim nr. 866, datë 24.12.2019, "Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale 2020-2023 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj";
- Vendim nr. 400, datë 30.06.2021 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për barazinë gjinore, 2021-2030, dhe të planit të saj të veprimit";
- Vendim nr.87, datë 03.06.2016 "Për miratimin e dokumentit politik të përfshirjes sociale 2016-2020".

VKM në zbatim të ligjit

- VKM nr. 518, date 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar".
- Vendim nr. 148, datë 13.3.2018 "Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave këshillimor e koordinues institucional, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave kombëtare e vendore, si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës".

- Vendim nr. 882, datë 24.12.2019 “Për mekanizmin e bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike”
- VKM Nr.334, datë 17.2.2011, “Për Mekanizmin e Bashkërendimit të Punës për Referimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare dhe Mënyrën e Procedimit të tij”
- VKM Nr.233, datë 10. 4.1998 “Për zbatimin e Ligjit “Për statusin e jetimit”.
- VKM nr. 578, datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.
- VKM nr. 111, datë 23.2.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e fondit social”.
- Vendimin nr. 150, datë 20.03.2019 të Këshillit të Ministrave “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”.
- Vendim Nr. 148, datë 13.3 2018 “Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave këshillimorë e koordinues institucionale, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave kombëtare e vendore, si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës”
- Vendim nr. 353, datë 12.6.2018 “Për rregullat e funksionimit të grupit teknik, ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve, pranë bashkive dhe njësive administrative”
- Vendim nr. 499, datë 29.8.2018 “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”
- Vendim nr.864, datë 24.12.2019 “Për miratimin e dokumentit politik kombëtar për moshimin,
- 2020-2024, dhe të planit të veprimit për zbatimin e tij”
- Vendim Nr.823, datë 6.12.2006, “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit në qendrat ditore”
- Vendim nr.822, datë 6.12.2006, “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar, në qendrat rezidenciale dhe ditore”

Urdhra/Udhëzime Ministri

- Urdhër nr. 624, datë 20.08.2016 “Për miratimin e Planit Operacional për punësimin e anëtarëve në moshë aktive pune të skemës së ndihmës ekonomike 2019-2020
- Udhëzim nr. 14, datë 10.5.2016 “Për ofrimin e shërbimit të emergjencës në institucionet e
- përkujdesit shoqëror të financuara nga fondet e buxhetit të shtetit publik që ofrojnë shërbime të përkujdesit rezidenciale për fëmijët në nevojë”

- Udhëzues i “Procedurave për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve në situatë rruge” 2015
- Udhëzim nr. 394, datë 9.5.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e komisionit multidisiplinar, si dhe procedurat dhe zbatimin e standardeve të shërbimit të përkujdesjes alternative për fëmijë në familje kujdestare”
- Udhëzim nr. 581, datë 18.12.2017, “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencë shtëpiake, për të moshuarit
- Udhëzimi nr.91, datë 27.12.2018 “Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në qendrat komunitare shumëdisiplinore
- Udhëzim nr.597, dt.22.12.17 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencë shtëpiake, për personat me aftësi të kufizuar”

SHTOJCA 1: NUMRI I FAMILJEVE QË TRAJTOHEN ME NE NGA FONDET E BASHKISË, SHTATOR-TETOR 2023

Tab 1-2

NUMRI I FAMILJEVE QË TRAJTOHEN ME NE. NGA FONDET E BASHKISE SHTATOR-TETOR 2023

E M Ë R T I M I	Njësia e matjes	Gjithsej	K/familjare	Ndarë në grup moshë			Nga keta sa me AK	Prej fillimit të vitit 2023
				0-6 vjec	6-15 vjec	15-18 vjec		
Numri I famileve gjithsej								
ME 1 ANETAR		71	31	36	52	35	13	153
ME 2 ANETARE		9	4	0	0	0	1	19
ME 3 ANETARE		6	4	2	0	3	6	18
ME 4 ANETARE		12	8	8	8	8	1	25
ME 5 ANETARE		24	10	16	25	9	1	47
ME 6 ANETARE		14	4	5	10	8	3	27
ME MBI 6 ANETARE		4	0	3	8	4	1	11
		2	1	2	1	3	0	6
Nga keta -me aftësi të kufizuar								
Nga keta - Rom		13						0
		1						21
								8
Fondi per familjet gjithsej	000/leke	Total	shtator	tetor				#VALUE!
		1,128,000	422,000	706,000	0	0	0	5,945,000
								0
ME 1 ANETAR		148,000	83,000	65,000				512,000
ME 2 ANETARE		72,000	32,000	40,000				706,000
ME 3 ANETARE		155,000	65,000	90,000				1,055,000
ME 4 ANETARE		317,000	122,000	195,000				1,663,000
ME 5 ANETARE		286,000	90,000	196,000				999,000
ME 6 ANETARE		60,000	20,000	40,000				592,000
ME MBI 6 ANETARE		90,000	10,000	80,000				418,000

SHTOJCA 2: TABELA PËRMBLEDHESE E PROGRAMIMIT TË FONDIT TË PAAFTËSISË PËR VITIN 2024

Bashkia Kamëz

Tabela përmbledhese e programimit të fondit të Paaftësisë për vitin 2024

Të dhënat janë marrë nga muaji nëntor 2023

Kamëz, datë 01.12.2023					
Nr	Emërtimi	Numri Personave	Masa Pagesës	Fondi mujor	Fondi vjetor
I	Personat me Aftësi të Kufizuar gjithsej (a+b+c) + Kujdestar	115		1,452,555	17,430,660
1	Me Aftësi të Kufizuar mendore, fizike gjithsej (a+b+c)	95		1,204,255	14,451,060
a	100%	93	12,415	1,154,595	13,855,140
b	200%	2	24,830	49,660	595,920
c	300%	-	37,245	-	-
d	Kujdestarë gjithsej	20		248,300	2,979,600
	100%	20	12,415	248,300	2,979,600
	150%	-	18,623	-	-
	Kompesim Energjie	-	640	-	-
	Heqja e fashos energjise	-	648	-	-
II	Të verbër gjithsej (a+b+c+d)+ kujdestar	464		7,581,864	90,982,368
2	Të verbër gjithsej (a+b+c+d)	351		5,312,684	63,752,208
a	100%	331	14,092	4,664,452	55,973,424
b	150%	4	21,138	84,552	1,014,624
c	200%	8	28,184	225,472	2,705,664
d	300%	8	42,276	338,208	4,058,496
	Kujdestarë gjithsej	113	14,092	1,592,396	19,108,752

	Kompesim Energjie për të Verbër me kujdestar	68	3,000	204,000	2,448,000
	Kompesim Energjie për të Verbër pa kujdestar	140	2,400	336,000	4,032,000
	Kompesim për heqjen e fashës deri 300 kwh	208	648	134,784	1,617,408
	Kompesim Telefoni për të Verbër gjithsej	2	1,000	2,000	24,000
III	Paraetetraplegjik + Kujdestar + Paketë H.S	647		9,475,411	113,704,932
3	Paraetetraplegjik gjithsej	217		2,731,300	32,775,600
a	100%	215	12,415	2,669,225	32,030,700
b	200%	1	24,830	24,830	297,960
c	300%	1	37,245	37,245	446,940
d	Kujdestarë gjithsej	215		2,803,815	33,645,780
	100%	215	13,041	2,803,815	33,645,780
	150%	-	19,561	-	-
e	Paketa Higjeno sanitare	215	16,000	3,440,000	41,280,000
	Kompesim Energjie për Paraetetraplegjik me kujdestar	139	3,000	417,000	5,004,000
	Kompesim Energjie për Paraetetraplegjik pa kujdestar	-	2,400	-	-
	Kompesim për heqjen e fashës deri në 300 kwh	127	648	82,296	987,552
	Kompesim Telefoni për Paraetetraplegjik gjithsej	1	1,000	1,000	12,000
IV	Nr. i invalidëve gjithsej (a+b+c+d)	1,583		5,095,600	61,147,200
a	Sëmundje Përgjithshme Grupi I	1,359	3,300	4,484,700	53,816,400
b	Sëmundje Përgjithshme Grupi II	110	2,200	242,000	2,904,000
c	Sëmundje Profesionale Grupi I.	47	4,000	188,000	2,256,000
d	Sëmundje Profesionale Grupi II.	67	2,700	180,900	2,170,800
V	Personat me Aftësi të Kufizuar gjithsej (Persona me AK+ Ndihmës Personal + Paketë Higjienosanitare)	1,978		21,153,711	253,844,532

VI	Persona me Aftësi të Kufizuar (Persona) (a+b+c+ç+d+dh+e+ë+f+g+gj+h)	1,499			16,112,359	193,348,308
a	Persona me kufizime të lehta (100 %)	434		7,729	3,354,386	40,252,632
b	Persona me kufizime të lehta (200%)	21		15,458	324,618	3,895,416
c	Persona me kufizime të lehta (300%)	6		23,187	139,122	1,669,464
ç	Persona me kufizime mesatare (100 %)	550		10,305	5,667,750	68,013,000
d	Persona me kufizime mesatare (200%)	5		20,610	103,050	1,236,600
dh	Persona me kufizime mesatare (300%)	5		30,915	154,575	1,854,900
e	Persona me kufizime të thella (100%)	459		12,882	5,912,838	70,954,056
ë	Persona me kufizime të thella (200 %)	12		25,764	309,168	3,710,016
f	Persona me kufizime të thella (300 %)	1		38,646	38,646	463,752
g	Persona me kufizime të rënda (100 %)	5		15,458	77,290	927,480
gj	Persona me kufizime të rënda (200%)	1		30,916	30,916	370,992
h	Persona me kufizime të rënda (300%)	-		46,374	-	-
VIII	Ndihmës personal gjithsej dhe Paketë higjieno-sanitare (a+b+c)	399			3,658,312	43,899,744
a	Shërbime gjithpërfshirëse	67		15,458	1,035,686	12,428,232
